



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 74 regjistër (JR)
Datë 26.11.2021

Nr. 2 i vendimit
Datë 16.01.2025

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 16.01.2025, ditën e enjte, në orën 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ken Dhima, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 428, datë 29.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ken Dhima.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63 dhe 66; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 46.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ken Dhima (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1; 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KL Gj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport¹ të hollësishëm, duke konstatuar se:

1. Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.
2. Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
3. Ka kryer fshehje të pasurisë.
4. Ka kryer deklaram të rremë.
5. Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 06.09.2018.

2.3 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLGj-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në kriterin e pasurisë, dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 428, datë 29.07.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 428, datë 29.07.2021, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

5.1. *“Komisioni, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, arrin në përfundimin se:*

1. *subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
2. *subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë;*
3. *subjekti nuk u tregua bashkëpunues gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer ndaj tij”.*

III. Mbi ankimin dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit

6. Më datë 28.10.2021, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë pranë Komisionit ankimin ndaj vendimit nr. 428, datë 29.07.2021, të Komisionit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63², pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë

6.1 *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 114,6 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën vetting, lidhur me vlerën/çmimin e blerjes së pasurisë apartament. Subjekti pretendon se nuk mund të bëhet krahasim midis burimeve të ligjshme të një pasurie, ku 70% e burimit të krijimit të saj është kredi bankare, e cila është paguar brenda 7 viteve.*

² Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

6.2 *Lidhur me pasurinë “njësi shërbimi” me sipërfaqe 44 m²*, ndodhur në rrugën “{***}” Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se fillimisht është blerë nga vjehri i tij. Ai sqaron se vjehri ka ndërruar jetë, ndaj e ka të vështirë të paraqesë të gjitha burimet e krijimit të kësaj pasurie në mënyrë të plotë dhe shteruese. Subjekti pretendon se mosprovimi i ligjshmërisë së burimit të kësaj pasurie, nuk varet nga subjekti apo bashkëshortja e tij, pasi është rezultat i informalitetit në Shqipëri.

6.3 *Lidhur me pasurinë “njësi shërbimi” me sipërfaqe 46 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se nuk provohet burimi i ligjshëm i kësaj pasurie. Ai shpjegon se si burim krijimi i pasurisë ka shërbyer huaja e marrë nga prindërit e bashkëshortes, Sh. dhe M. Ç., transferuar nëpërmjet llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, në vlerën 14.000.000 lekë.

6.4 *Lidhur me dy pasuritë e llojit “garazh”, me sipërfaqe përkatësisht nga 18,2 m² dhe 18,9 m²*, të ndodhura në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se burimi i krijimit të këtyre pasurive kanë qenë të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si gjyqtarë, dhe të ardhurat nga dhënia me qira, vëllait të tij, të pasurisë “njësi shërbimi me sip. 46 m²”, e ndodhur në rrugën “{***}” Tiranë.

6.5 *Lidhur me pasurinë “njësi shërbimi” me sip. 47 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë pasuri e ka marrë në dorëzim të papërfunduar, në gjendjen karabina dhe pretendon se Komisioni, në mënyrë të qëllimshme, ka konsideruar se shuma e detyrimit të mbetur ndaj subjektit është në vlerën 246.429 euro. Subjekti sqaron se ka deklaruar në deklaratat e pasurisë shumë e shlyer, si dhe shumë e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare e pasqyruar në vendim për këtë pasuri, nuk është e vërtetë.

6.6 *Lidhur me apartamentin me sip. 109 m², të ndodhur në {***}*, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se kjo nuk është pasuri e tij, por e vëllait, e krijuar nga puna për vite të tëra në emigracion, ndaj kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe diferencën negative në shumë 7.000.000 lekë.

6.7 *Lidhur me pasurinë “njësi tregtare” me sip. 124 m²*, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i vendimit të Komisionit se kjo pasuri i atribuohet atij, është i gabuar dhe aludues. Subjekti sqaron se ka paraqitur të gjitha provat shkresore që provojnë se ka qenë dorëzanës në kredinë që ka marrë kunati i tij A. Ç..

6.8 *Lidhur me pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {***}*, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, për shkak të një pakujdesie, ka deklaruar se ky automjet është dhuruar nga Z. R. H., i cili ka qenë përfaqësues me prokurë për automjetin që i është dhuruar subjektit nga Z. A. P..

6.9 *Lidhur me dhurimet, huatë, sponsorizimet/ndihma financiare e shpërblime*, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka bërë vetë deklarime disa herë para ILDKPKI-së, ashtu edhe para oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Sipas subjektit, të

gjitha këto sponsorizime janë konfirmuar edhe me akt noterial dhe burimet e personave të lidhur kanë qenë të ligjshme.

7. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit, kërkoi:

Prishjen e vendimit nr. 428, datë 29.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Pavlefshmërinë e vendimit nr. 428, datë 29.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës dëgjimore, vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të trupit gjykues.

Përsëritjen e hetimit gjyqësor, brenda shkaqeve të ankimit. Marrjen e provave të kërkuara prej subjektit të rivlerësimit, duke e gjykuar çështjen në seancë gjyqësore publike, kryerjen e hetimit dhe për dy kriteret e tjera.

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Ken Dhima, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

i. *Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Legjitimimi i ankuesit*

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur Kolegji, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë

gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 428, datë 29.07.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

10.1 Gjatë shqyrtimit në dhomë këshillimi, u konstatua se shkak i ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të zbatimit të dispozitave procedurale, u gjet i drejtë, pasi Komisioni duhet të kishte konsideruar se subjekti i rivlerësimit, për arsye objektive, e kishte të pamundur të paraqitej në seancë publike. Komisioni, në konsideratë të raportit³ mjekësor të lëshuar nga mjeku përkatës, duhet të kishte shtyrë seancën publike pas përfundimit të periudhës së paaftësisë në punë, duke respektuar jo vetëm të drejtën e subjektit për kujdes shëndetësor, por duke i garantuar atij një proces të rregullt ligjor, me qëllim realizimin e një mbrojtjeje efektive për të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, pa ia kthyer çështjen për rishqyrtim, me qëllim korrigjimin e gabimit procedural të kryer Komisionit, konkretisht, zhvillimin e seancës gjyqësore publike pa praninë e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që ky i fundit kishte paraqitur një raport mjekësor për paaftësi në punë, dhe për t'i garantuar subjektit të rivlerësimit mbrojtjen e të drejtave të tij themelore, në përputhje me nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 51, pika 1, shkronja "b" e ligjit nr. 49/2012, vendosi të shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit të rivlerësimit, për ta dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për çështjen e tij. Për këtë qëllim, seanca publike u caktua në datën 16.01.2025, ora 10:00. Në këtë mënyrë, Kolegji zgjidhi pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkeljen procedurale nga ana e Komisionit në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e subjektit të rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike, Kolegji konstatoi si më poshtë:

11. Sekretaria Gjyqësore e Kolegjit, me qëllim njoftimin e subjektit të rivlerësimit për seancën gjyqësore publike që do të zhvillohej në Kolegj, ka vijuar me njoftimin e subjektit nëpërmjet komunikimit elektronik, në zbatim të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, në adresën elektronike të deklaruar në Komision dhe ILDKPKI. Ky komunikim është përcjellë për subjektin e rivlerësimit në adresën e tij elektronike në datën 12.12.2024, si dhe është ridërguar në datën 16.12.2024, duke pasqyruar dhe nevojën që ai të sigurojë prezencën e tij në këtë seancë apo prezencën e një përfaqësuesi ligjor. Të dyja këto komunikime nuk kanë një kthim përgjigjeje prej tij për marrjen dijeni të tyre. Në të njëjtën adresë elektronike, subjekti ka dërguar në Kolegj, më datë 11.12.2024, kërkesën drejtuar relatores së çështjes në Kolegj, "Për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes". Sekretaria Gjyqësore e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka dërguar njoftimin për subjektin e rivlerësimit në dy adresat e tij të vendbanimit, që rezultojnë nga procesi i rivlerësimit i kryer në Komision, duke marrë të njëjtën përgjigje, që objekti nuk dorëzohet për shkak se adresa nuk aksesohet, nuk gjendet në banesë.

³ Raport mjekësor për paaftësi në punë, i cili përcaktonte 3 ditë pushim, duke filluar nga data 27.07.2021 dhe afatësinë për punë në datën 30.07.2021. Diagnoza e përcaktuar në raport është "{***}", me këshillim nga mjeku "pushim + mjekim".

11.1 Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në vijim dhe në zbatim të nenit 460, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Civile, ka urdhëruar njoftimin për seancën gjyqësore nëpërmjet shpalljes së vendosur në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, shpallje e cila në datën 12.12.2024, rezultoi të jetë afishuar nga korrieri i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe një punonjëse e pranishme pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjithashtu, për të mundësuar njoftimin e subjektit për seancën gjyqësore publike, Sekretaria Gjyqësore e Kolegjit ka vijuar më tej me zbatimin e neneve 133/a dhe 133/b të Kodit të Procedurës Civile, duke realizuar njoftimin me shpallje publike në këndin e afishimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe Bashkisë Tiranë, e cila ka përcjellë shpalljen publike në njësitet Administrative nr. 9 dhe nr. 11, pjesë e të cilave janë adresat e subjektit të rivlerësimit. Përveç këtyre mënyrave, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka tentuar të komunikojë me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet komunikimit në numrat e tij të telefonit, numra të cilat janë identifikuar dhe ekstraktuar nga dosja e ILDKPKI-së që i përket subjektit të rivlerësimit, si dhe nga një dokument i paraqitur prej tij në datën 06.01.2023, me objekt: “Kërkesë për përsheptimin e gjykimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”. Gjithashtu, është dërguar njoftimi i subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet njoftimit të akteve që lidhen me gjykimin e çështjes së tij, edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, në të cilën subjekti i rivlerësimit është i emëruar në cilësinë e gjyqtarit.

11.2 Në seancën gjyqësore publike të datës 16.01.2025, Kolegji çeli hetimin gjyqësor për të hetuar faktet e pretenduara në ankim, për t’i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të paraqesë prova dhe të shpjegohet në lidhje me to. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqiti ditën e seancës gjyqësore publike në Kolegji, dhe as dërgoi përfaqësues ligjor, me gjithë njoftimet e kryera nga Sekretaria Gjyqësore e Kolegjit, gjithashtu nuk paraqiti parashtrime dhe prova për t’u mbrojtur e dëgjuar në Kolegji, sikundër pretendoi në ankim. Nuk rezultoi të jetë njoftuar prej tij ndonjë arsye objektive e mbështetur me dokumentacion që të përligjte pamundësinë e tij për të qenë prezent personalisht vetë ose përfaqësuesi i tij ligjor në këtë seancë publike, por as nuk ka kthyer përgjigje për të konfirmuar dijeninë e tij, pavarësisht përdorimit të të gjitha mjeteve të komunikimit në zbatim të ligjit nr. 84/2016, por edhe në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 175, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile, vendosi që ta zhvillojë këtë seancë në mungesë të subjektit të rivlerësimit, i cili rezultoi të ketë marrë dijeni në përputhje me ligjin për zhvillimin e kësaj seance gjyqësore dhe, pa shkaqe të arsyeshme, nuk është paraqitur.

C. Në lidhje me shkaqet e ankimit dhe vlerësimin e tyre mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

12. ***Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 114,6 m²***, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën vetting, lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie. Subjekti shpjegon se 70% e burimit të krijimit të pasurisë, është kredi bankare, e cila është paguar brenda 7 viteve. Ai sqaron se kontrata tip e shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK ka lapsuse në lidhje me çmimin, i cili është 74.400 euro dhe jo 52.000 euro. Subjekti pretendon gjithashtu se moskonsiderimi i huasë së marrë nga z. A. Ç., është bazuar në aludime nga Komisioni, duke shpjeguar se z. A. Ç. është një mik i familjes dhe

kjo hua nuk është bazuar në fitime, por në ndihmën e ndërsjellë. Subjekti shpjegon në ankim se kontrata e huasë është lidhur në datën 22.07.2005, rreth një muaj pas pagesës së kështit të parë, që përbën rreth 30% të çmimit të apartamentit. Subjekti sqaron se kjo hua është marrë *de facto* më herët, por kontrata është materializuar me akt noterial në një moment të përshtatshëm, bazuar edhe në besimin reciprok që kishin ndaj njëri tjetrit. Subjekti kundërshton analizën financiare për periudhën 01.01.2004 - 30.08.2004, duke pretenduar se Komisioni nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë analizë se përse janë përlllogaritur 8 muaj nga viti 2004, duke mos konsideruar faktin se ai me bashkëshorten kanë qenë studentë dhe kanë pasur ndihmën e prindërve. Subjekti sqaron se mospagimi i plotë i huasë është bërë me pëlqimin e huadhënësit dhe se kjo hua, bashkë me interesat, do të paguhet në një moment të dytë. Në lidhje me mundësinë financiare të huadhënësit, subjekti shpjegon se z. A. Ç. ka punuar për vite me radhë si emigrant në Greqi dhe, më pas, ka punuar në Shqipëri në sektorin privat, kundrejt një page të kënaqshme.

12.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, në vendim, është: *Trupi gjykues, bazuar në analizën e kryer mbi mundësinë e krijimit të likuiditeteve gjendje në bankë në vitin 2004, analizën e kryer lidhur me marrëdhënien e deklaruar të huasë me shtetasin A.Ç., si edhe për të ardhurat e deklaruar si autor libri, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar kryerjen e pagesës së kështit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

12.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie: (i) të ardhurat nga paga si student i Shkollës së Magjistraturës; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes, K. Ç., si studente e Shkollës së Magjistraturës; (iii) të ardhurat nga paga si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Shkodër; (iv) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (v) kredinë e marrë në Tirana Bank me kontratën e datës 22.07.2005, në shumën 52.000 euro; (vi) huanë e marrë nga z. A. Ç., në shumën prej 2.000.000 lekësh, sipas kontratës së huasë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 19.08.2005; dhe (vii) të ardhurat prej 300.000 lekësh të siguruara nga shitja e librit, ku subjekti është bashkautor i tekstit me titull “Fjalori i termave të së drejtës, italisht – shqip – italisht”.

Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament 2+1, me sip 124 m², data e krijimit 03.06.2005, adresa: rr. “{***}”, Tiranë. Vlera e pasurisë 74.400 euro, pjesa takuese 50%.*

Në këtë deklaratë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar detyrimet financiare të krijuara ndaj të tretëve gjatë vitit 2005, si vijojnë:

- (i) Kontratë huaje afatgjatë për blerje apartamenti, huadhënësi Tirana Bank, 52.000 euro, afati i shlyerjes 15 vjet, interesi 8% në vit, kësti 487 euro/muaj. Detyrimi i mbetur 51.000 euro.
- (ii) Kontratë huaje, shuma 2.000.000 lekë. Fillimi i kontratës 20.06.2005, përfundimi i kontratës 20.06.2010, interesi 5% në vit, huadhënësi A. Ç.. Detyrimi i mbetur nuk është shënuar në DIPP-në e vitit 2005.

Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova lidhur me konstatimin. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në Komision shpjegime mbi rezultatet e hetimit.

12.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se më datë 03.06.2005, është lidhur kontrata⁴ e shitjes me rezervë me nr. {***} prot., ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e palës shitëse, dhe subjektit të rivlerësimit e bashkëshortes së tij, në cilësinë e palës blerëse. Pasuria objekt kontrate është apartamenti me sipërfaqe ndërtimi në total 124 m², i përbërë nga 114,6 m² sipërfaqe apartamenti dhe 9,4 m² sipërfaqe të përbashkëta. Çmimi i shitjes së apartamentit, sipas kontratës, është 74.400 euro, dhe plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) blerësi do paguajë vlerën prej 22.400 eurosh me nënshkrimin e kontratës; dhe (ii) vlerën prej 52.000 eurosh do e paguajë me kredi bankare brenda datës 30.07.2005.

12.4 Në datën 07.04.2015, është lidhur kontrata e shitjes për këtë apartament, ndërmjet palëve cituar në paragrafin më sipër, në vend të bashkëshortes së subjektit, ka nënshkruar përfaqësuesi me prokurë, z. A. Ç.. Sipas kësaj kontrate, blerësit e kanë paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes (74.400 euro) së apartamentit objekt kontrolli. Kjo pasuri, sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. {***}, është regjistruar në ZVRPP Tiranë në datën 14.04.2015, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, nga Tirana Bank, pagesa për blerjen e apartamentit është kryer në dy kështe, në datën 03.06.2005, nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në Tirana Bank është transferuar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, shuma prej 2.770.000 lekësh (konvertuar 22.400 euro), si dhe referuar në datën 23.08.2005, nga llogaria e kredisë e hapur në emër të bashkëshortes së subjektit në Tirana Bank, është transferuar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, shuma prej 52.000 eurosh. Gjatë hetimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit për sa më sipër, pagesa e kështit të dytë për blerjen e apartamentit, është kryer me fondet e disbursuara nga kredia e marrë në “Tirana Bank”, në shumën prej 51.000 eurosh dhe shuma prej 1.000 eurosh, pjesë e fondeve të depozituara *cash* nga subjekti në llogarinë bankare të kredisë në datën 23.08.2005. Në vijim, nga kjo llogari, po në datën 23.08.2005, transferohet në favor të shoqërisë së ndërtimit, shuma prej 52.000 eurosh, me përshkrimin “Likuidim apartamenti” – për rrjedhojë, Komisioni ka konkluduar se nuk lindin dyshime lidhur me pagesën e kryer për këtë kësht.

12.5 Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së kështit të parë për blerjen e apartamentit, në përgjigje të të cilit, subjekti sqaroi se burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e shumës prej 2.770.000 lekësh në datën 03.06.2005, ka qenë paga e tij dhe e bashkëshortes në Shkollën e Magjistraturës, paga e tij dhe e bashkëshortes si gjyqtar/e, si dhe huaja e dhënë nga z. A. Ç. në shumën prej 2.000.000 lekësh. Komisioni verifikoi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të investuar në depozitat bankare nga 01.01.2004 deri në datën 31.08.2004, duke

⁴ Kontratë e përpiluar jashtë zyrës noteriale, por e nënshkruar para noterit publik dhe konfirmuar me dokumentin vërtetim nënshkrimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2005.

qenë se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* deri në vitin 2003, si dhe nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të depozitave, si rrjedhojë kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën e mësipërme, në të cilën është paguar edhe kësti prej 2.770.000 lekësh. Nga analiza e Komisionit, rezultoi diferenca negative në shumën (-)810.725 lekë. Lidhur me këto rezultate, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës mbi mundësinë e krijimit të likuiditeteve gjendje në bankë në vitin 2004. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në Komision prapësime mbi rezultatet e hetimit, si dhe as dokumentacion për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

12.6 Siç rezultoi në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, huanë e marrë nga z. A. Ç., në shumën prej 2.000.000 lekësh. Gjithashtu, në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar detyrimin në shumën prej 2.000.000 lekësh nga huaja e marrë shtetasit A. Ç. në vitin 2005.

Në DIPP-në e vitit 2005, në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: *Kontratë huaje, shuma 2.000.000 lekë. Fillimi i kontratës 20.06.2005, përfundimi i kontratës 20.06.2010, interesi 5% në vit, huadhënësi A. Ç..* Në DIPP-të e viteve 2006, 2007 dhe 2008, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar këtë hua si të pashlyer, dhe detyrimin e mbetur ndaj huadhënësit, në shumën prej 2.000.000 lekësh. Në DIPP-të e viteve 2009 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë hua, as si shuma të shlyera, as si detyrim i mbetur. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.03.2021, ka përcjellë në Komision deklaratat periodike të viteve 2018 dhe 2019, sipas të cilave rezulton se në DIPP-në e vitit 2018, deklarohet se është shlyer nga kjo hua shuma prej 800.000 lekësh, dhe detyrimi i mbetur është deklaruar në shumën prej 1.200.000 lekësh. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2019, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi të dhëna lidhur me këtë hua.

12.7 Në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje, referuar kontratës së huasë së datës 22.07.2005, vërtetuar me autentifikim⁵ nënshkrimi para noterit, një vit më vonë (09.06.2006), subjekti i rivlerësimit i ka marrë hua z. A. Ç. shumën prej 2.000.000 lekësh, për një afat prej 5 vitesh, me interes 5% në vit.

Sipas parashikimeve të kësaj kontrate, interesi do të paguhej çdo vit, me një këst të vetëm, shuma do të likuidohet në pesë këste dhe likuidimi do fillonte pas një viti nga lidhja e kontratës. Datat e kësteve janë lënë në mirëbesim të palëve. Kontrata parashikon se, në rast se huamarrësi nuk paguan gjysmën e shumës së huasë brenda katër viteve nga lidhja e saj, atëherë huadhënësi mund të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së huasë, ndërsa mospagimi i dy kësteve të njëpasnjëshme sjell gjithashtu zgjidhjen e kontratës së huasë.

Rezulton se më datë 29.10.2016, palët e cituara më sipër kanë nënshkruar deklaratë noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., sipas së cilës huadhënësi, z. A. Ç., ka deklaruar se: [...] *i kam dhënë hua z. Ken Dhima, shumën prej 2.000.000 lekësh. Kjo shumë është përfituar prej punës disaveqare të bërë prej meje në Greqi. Nga huaja e dhënë nuk më është paguar asnjë këst, fakt ky që e kam toleruar për shkak të marrëdhënieve miqësore që kam me z. Ken Dhima. Dhënia e huasë*

⁵ Autentifikim nënshkrimi me nr. rep. {***}, datë 09.06.2006.

nuk është realizuar me mandat bankar, por është dhënë cash në dorë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është dakord me deklarimet e z. Ç..

12.8 Komisioni konstatoi se me kontratën⁶ e datës 16.07.2015, subjekti privat “A. Ç.” Person Fizik, regjistruar me NIPT {***}, ka marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, njësi shërbimi me sip. 44 m² në pronësi të tyre, me qira mujore sipas kësaj kontrate në shumën prej 172.500 lekësh. Afati i kontratës së qirasë është përcaktuar 5 vjet, dhe ka filluar në datën 01.05.2015. Ndërsa, nëpërmjet vërtetimit të datës 30.12.2016, z. A. Ç., në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit tregtar “A.Ç.” Person Fizik, sqaron se, gjatë kohëzgjatjes së qirasë për njësinë 44 m², me adresë: rruga “{***}”, Tiranë, me vlerë totale mujore qiraje 172.500 lekë në muaj, është paguar në mënyrë të rregullt qiraja (pjesa e mbetur pas mbajtjes së tatimit në burim 15%) në masën 146.625 lekë në muaj ose në masën 2.932.500 lekë deri në datën 31.12.2016.

Megjithëse kontrata e qirasë është nënshkruar në datën 16.07.2015, në të cilën referohet fakti se afati i qirasë ka filluar më 01.05.2015, Komisioni konstatoi se në QKB, subjekti “A. Ç.” Person Fizik e ka regjistruar njësinë e marrë me qira si adresë sekondare në datën 11.11.2015. Komisioni i kërkoi subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të sqarojë këtë marrëdhënie ku subjekti, për një periudhë të gjatë kohore, nuk ka shlyer huanë e marrë nga z. A. Ç., ndërsa nga ana tjetër ky i fundit i ka paguar qira për dyqanin deri në datën 31.12.2016, në vlerën prej 2.932.500 lekësh, në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit sqaroi se nuk e ka shlyer huanë ndaj tij, pasi ka pasur shpenzime të tjera më të rëndësishme.

12.9 Komisioni, bazuar në pikën 14 të nenit 3, si dhe në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se z. A. Ç. bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, saktësisht të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 2.000.000 lekë. Pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. Ç., për këtë arsye Komisioni arriti në përfundimin se personi tjetër i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar dhënien e huasë në favor të subjektit të rivlerësimit.

12.10 Në analizë të sa më sipër, Kolegjit, ashtu si Komisionit, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përdorur si burim për krijimin e pagesës së kësaj të parë të pasurisë objekt kontrolli, huanë në shumën prej 2.000.000 lekësh, të marrë nga z. A. Ç., sipas kontratës së huasë datë 22.07.2005. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2005, por e ka deklaruar në rubrikën “Të dhëna që nuk publikohen” të kësaj deklarate, kontratën e huasë me z. Ç.. Kjo hua, sipas deklarimit periodik të vitit 2018, është shlyer në shumën 800.000 lekë, ndërsa në deklaratën e vitit 2019 nuk është deklaruar gjendje apo pakësim i këtij detyrimi financiar. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve në rezultatet e hetimit në kuadër të detyrimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Detyrimi i subjektit për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume vjen edhe në zbatim të drejtpërdrejtë të parashikimit kushtetues për të provuar bindshëm burimet e

⁶ Kontrata e qirasë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 16.07.2015.

krijimit të pasurisë sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht se nga gjenerohet ai. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume prej huadhënësit, në funksion të detyrimit që buron nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, si e ardhur e ligjshme për pagesën e kësaj pasurie.

12.11 Në funksion të kontrollit të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e kësaj pasurie për blerjen e apartamentit, Komisioni analizoi edhe shumën prej 250.000 lekësh të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2005, si e ardhur e përfutur në këtë vit (viti që është blerë apartamenti), e pretenduar prej subjektit si e përfutur nga autorësia e librit të tij. Rezulton se Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar këto të ardhura me dokumentacion provues ligjor, pas së cilës, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar këto të ardhura, si rrjedhojë Kolegji e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për të mos i përfshirë ato në analizën financiare të këtij viti. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, si e ardhur e ligjshme për pagesën e kësaj pasurie.

12.12 Në përfundim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të ardhurat e pretenduara si të krijuara nga shitja e librit, në shumën 250.000 lekë, si dhe dështoi të provojë mundësitë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë huanë prej 2.000.000 lekësh subjektit të rivlerësimit, shuma këto, të cilat kanë shërbyer si burim për pagesën e kësaj pasurie për blerjen e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-)810.725 lekë, për pagesën e kësaj pasurie prej 2.770.000 lekësh, për blerjen e apartamentit, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 13. *Lidhur me pasurinë “njësi shërbimi” me sipërfaqe 44 m²***, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo pasuri fillimisht është blerë nga vjehri i tij. Sipas subjektit, kontrata e shitjes është realizuar para noterit, bazuar në çmimin e referencës së përcaktuar në zonë. Subjekti pretendon në ankim se ka depozituar të gjitha provat shkresore të vërtetuara me akte noteriale për këtë pasuri. Gjithashtu, sqaron se, bashkë me deklaratën *vetting*, në ILDKPKI ka paraqitur edhe kontratën e shitblerjes së pasurisë nga vjehri i tij dhe kontratën e dhurimit që ky i fundit ka bërë për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij. Lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka shpjeguar se është krijuar me të ardhurat e vjehrit nga puna disavjeçare së bashku me kunetërit e tij në emigracion (punësim i cili ka qenë i paligjshëm dhe nuk mund ta provojë me dokumentacion ligjor), ushtrimi i veprimtarisë tregtare të “{***}”, si dhe veprimtaria tregtare si shitës me shumicë e pakicë për disa vjet të tregu i “Medresesë”, për të cilat subjekti pretendon se ka dorëzuar edhe provat shkresore. Subjekti sqaron se vjehri i tij ka ndërruar jetë dhe e ka të vështirë të paraqesë të gjitha burimet e krijimit të kësaj pasurie në mënyrë të plotë dhe shteruese. Subjekti pretendon se mosprovimi i ligjshmërisë së burimit të kësaj pasurie nuk varet nga subjekti apo bashkëshortja e tij, pasi është rezultat i informalitetit në Shqipëri.

13.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, në vendim, është: *Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur për të mundësuar blerjen e pasurisë së llojit “njësi shërbimi”, të dhuruar në tetor të vitit 2012, në favor të tij dhe personit të lidhur (bashkëshortes).*

13.2 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Dyqan i dhuruar nga vjehri im Sh. Ç., datë 19.10.2012, me sip. 44 m². Pjesa takuese 50%.*

Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Ambient shërbimi (dyqan) me sip. 44 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 26.11.2013. Viti i krijimit 2012. Burimi i krijimit: Kontrata e dhurimit nga shtetasi Sh. Ç. (vjehri im), të pasqyruar në kontratën e dhurimit me akt noterial nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 19.10.2012. Vlera e pronës pas rivlerësimit 21.000.000 lekë. Pjesa takuese ½.*

13.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, referuar dokumentit vërtetim nga dokumenti hipotekor (datë lëshimi 25.11.2011), ka rezultuar se në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 23.11.2011, figuron e regjistruar në pronësi të z. Sh. Ç. (babai i bashkëshortes së subjektit), pasuria me nr. {***}, e ndodhur në Z.K. {***}, me sipërfaqe 44 m², në rrugën “{***}”, Tiranë. Me kontratën e dhurimit⁷ të datës 19.10.2012, z. Sh. Ç., në cilësinë e palës dhuruese, ia dhuron këtë pasuri subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (vajzës së tij). Në datën 21.08.2013, referuar kartelës së pasurisë, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, është regjistruar në ZVRPP Tiranë, pasuria e llojit “njësi”, me sipërfaqe 44 m², ndodhur në rrugën “{***}”, me nr. {***}. Në kartelën e pasurisë, në seksionin “Përshkrim i veçantë”, është shënuar: *Vlera e tregut të pasurisë, sipas çmimeve të vitit 2012, është 21.000.000 lekë.* Në datën 22.12.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij e kanë shitur⁸ këtë pasuri për çmimin 100.000 euro. Nga dokumentacioni i cituar më sipër, evidentohet se pasuria ka numra të ndryshëm regjistrimi, ku në vërtetimin nga dokumenti hipotekor, datë 25.11.2011, rezulton me nr. {***}, ndërsa në kartelën e pasurisë të vitit 2013, pas regjistrimit në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, figuron me numër pasurie {***}, pra i ndryshëm nga ai i dokumentit hipotekor. Komisioni, pasi ka konstatuar se pasuria e dhuruar ka numër të ndryshëm me atë të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit pas dhurimit, i kaloi subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime nëse është e njëjta pasuri. Subjekti, siç është sqaruar edhe më lart, nuk ka dorëzuar shpjegime dhe prova për rezultatet e hetimit.

13.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se nga dokumenti hipotekor, lëshuar në datë 25.11.2011, evidentohet regjistrimi i njësisë së shërbimit me nr. pasurie {***}, në emër të z. Sh. Ç., fillimisht e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 11.12.2009.

Komisioni konstatoi se vjehri i subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar si person fizik me NIPT-in përkatës, që nga data 09.06.2009, me adresë ushtrimi aktiviteti rruga “{***}”, përballë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, adresë e cila duket e njëjtë me adresën e njësisë së

⁷ Kontrata e dhurimit me nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 19.10.2012.

⁸ Kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} prot., datë 22.12.2017.

shërbimit të dhuruar në favor të subjektit të rivlerësimit në vitin 2012. Në pyetësin nr. 2 të Komisionit, subjekti ka sqaruar se në këtë njësi, është ushtruar aktivitet “Bar-kafe” dhe para se t’i dhurohej kjo pasuri, disponohej dhe përdorej nga vjehri i tij, por subjekti nuk e mban mend nëse ai e kishte dhënë me qira apo e administronte vetë lokalin. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se, pas dhurimit, sipas aktit noterial të datës 18.11.2013, ky ambient i është dhënë me qira vëllait të tij, E. Dh., dhe se nuk mban mend më pas se kush e ka përdorur këtë njësi shërbimi për periudhën 19.10.2012 - 31.12.2016, pasi, për shkak të falimentimit, lokali ka qenë i mbyllur për disa kohë.

13.5 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, nëpërmjet kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2013, i kanë dhënë me qira z. E. Dh. (vëllai i subjektit), ambientin “njësi shërbimi” me sipërfaqe 44 m², me destinacion biznes (bar-kafe), për periudhën 15.11.2013 - 15.11.2015, me të drejtë përsëritjeje jo më shumë se pesë vjet, dhe me një qira mujore prej 150.000 lekësh/muaj.

Komisioni konstatoi se në datën 21.11.2013, është regjistruar subjekti “E. Dh.” Person Fizik, për ushtrimin e aktivitetit “Bar-kafe”, me adresë ushtrimi aktiviteti në Tiranë, rruga “{***}”, pallati përballë Prokurorisë.

Të dyja subjektet tregtare (“Sh. Ç.” Person Fizik dhe “E. Dh.” Person Fizik), të cilët duket se figurojnë të regjistruar me adresë ushtrimi aktiviteti në njësinë e shërbimit të dhuruar në favor të subjektit në tetor të vitit 2012, figurojnë me status “aktiv”.

Sa i përket subjektit tregtar “A. Ç.”, ka regjistruar në QKB si adresë sekondare dyqanin e marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit në datën 11.11.2015, ndërsa në datën 20.01.2017, e ka hequr si adresë ushtrimi aktiviteti. Lidhur me sa më sipër, Komisioni, në rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të japë shpjegime shteruese dhe të deklarojë në mënyrë kronologjike lidhur me përdorimin e këtij ambienti pas fitimit të pronësisë nga subjekti nëpërmjet dhurimit, duke saktësuar periudhën e përdorimit nga secili subjekt/individ, nëse përdorimi ka qenë me apo pa kundërshtim, dhe mbi të ardhurat e mundshme të përfituara nga subjekti, sipas periudhave përkatëse. Subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë shpjegim, si dhe nuk dorëzoi dokumentacion për kërkimet e Komisionit lidhur me saktësimet e mësipërme.

13.6 Gjithashtu, bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, z. Sh. Ç., si person që i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit pasurinë objekt kontrolli, futet në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin ligjor të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, për rrjedhojë të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

Në pyetësin standard të Komisionit, subjekti është pyetur lidhur me dhurimet, shumën dhe arsyen e dhurimit të pasurisë, për të cilat subjekti ka sqaruar se: *Vjehri dhe kunetërit kanë punuar jashtë shtetit në emigracion, Greqi, si dhe kanë ushtruar biznes për vite me radhë te tregu i “Medresesë” me shumicë dhe pakicë ndër vite, si dhe kanë pasur në pronësi hotel-bar-restorant në fshatin {***}, Pogradec, nga ku kanë nxjerrë të ardhurat përkatëse. Gjithashtu, vjehri ka ushtruar dhe veprimtarinë e këmbimit valutor për disa vite, i palicencuar, si rezultat i informalitetit që ka ekzistuar në atë kohë.*

13.7 Në analizë të sa më sipër, për pasurinë objekt kontrolli, rezulton se nuk është qartësuar nga subjekti i rivlerësimit periudha e përdorimit nga vjehri dhe kunati i tij, i njësisë me sip. 44 m², si dhe nëse ai ka gjeneruar të ardhura nga dhënia në përdorim e me qira e këtij ambienti.

Në kushtet kur subjekti nuk mundësoi me akte verifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nga dhuruesi, Kolegji e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi detyrimin e parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur (babait të bashkëshortes), për të mundësuar blerjen e pasurisë së llojit “njësi shërbimi”, të dhuruar në vitin 2012 në favor të tij dhe bashkëshortes së tij. Sa më sipër, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mundësinë e personit tjetër të lidhur për blerjen me burime financiare të ligjshme të kësaj pasurie, të cilën më pas ia ka dhuruar subjektit dhe bashkëshortes së tij, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

14. **Lidhur me pasurinë “njësi shërbimi” me sipërfaqe 46 m²**, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, se nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie. Subjekti shpjegon se si burim për blerjen e saj, ka shërbyer huaja e marrë nga prindërit e bashkëshortes, Sh. dhe M. Ç., transferuar nëpërmjet llogarisë bankare në Raiffeisen Bank, në vlerën 14.000.000 lekë. Kjo hua është shlyer nëpërmjet kredisë bankare të marrë te Banka Societe Generale Albania dhe të gjitha veprimet bankare janë dokumentuar, duke e paraqitur në formë shkresore së bashku me deklaratën *vetting*. Subjekti pretendon se Komisioni duhet të konsideronte këtë pasuri si të krijuar me burime financiare të ligjshme, të prejardhura nga shpronësimi publik.

14.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, në vendim, është: *Në analizën financiare të vitit 2015, nuk do të pasqyrohet si hua shuma prej 700.000 lekësh, e pretenduar nga subjekti si e marrë hua gjatë këtij viti nga prindërit e bashkëshortes, krahas shumës prej 14.000.000 lekësh. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se personat e tjerë të lidhur (prindërit e bashkëshortes së subjektit) kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huasë gjatë vitit 2015, në vlerën prej 14.000.000 lekësh, konfirmuar kalimi i kësaj shume nëpërmjet transfertës bankare. [...] Në kushtet kur subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi prova të reja të mundshme për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, trupi gjykues arrin në konkluzion se ai nuk arriti të provojë ligjshmërinë e shumës prej 500.000 lekësh, të pretenduar nga marrëdhënia e qiradhënies me shtetasin A. Ç., deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie.*

14.2 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ambient me sip. 46 m², në {***}, në Njësinë Administrative nr. 11, Tiranë, likuiduar plotësisht dhe e regjistruar në ZVRPP Tiranë. Burimi i krijimit, të ardhurat e përfituara sipas VKM-së me nr. 909, datë 22.12.2014, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitim i bregut të liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës Lin - Pogradec”, në shumën 7.000.000 lekë, dhe të ardhura nga dhënia e njësisë me qira subjektit tregtar “A. Ç.” Person Fizik, më datë 01.05.2015, në shumën prej 500.000 lekësh.

Në DIPP-në e vitit 2016, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrim sipas kontratës së huasë ndaj znj. M. Ç.. Shlyer shuma prej 14.000.000 lekësh nëpërmjet bankës, nga kredia bankare, detyrimi i mbetur 700.000 lekë.

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri me burim krijimi huanë e marrë nga prindërit e bashkëshortes nëpërmjet llogarisë bankare në Raiffeissen Bank në vlerën totale 14.000.000 lekë, e konfirmuar sipas deklaratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2016. Burimi i krijimit të kësaj shume të marrë hua nga prindërit e bashkëshortes, është shuma e përfituar nga VKM-ja nr. 222, datë 11.03.2015, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit Qafthanë-Lin-Pogradec (loti 2)”.

14.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me kontratën⁹ e shitblerjes, datë 17.08.2015, ka blerë pasurinë “njësi” me sipërfaqe 46 m², ndodhur në rrugën “{***}”, {***}, Tiranë, për çmimin prej 7.500.000 lekësh. Sipas kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, çmimi është likuiduar tërësisht në llogarinë në Alpha Bank, të noteres R. R.. Më datë 20.08.2015, kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP Tiranë, sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. {***}, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. K. Ç.. Kolegji vëren se, nga dokumentacioni i dosjes, rezultoi se vjehri i subjektit të rivlerësimit ka përfituar nga shpronësimi i objektit në pronësi të tij në fshatin {***}, Pogradec, shumën prej 14.712.113 lekësh, prej të cilave rezulton se 14.000.000 lekë janë transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, pasi kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, si dhe një pasuri tjetër.

14.4 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me deklaratën *vetting*, deklaratën¹⁰ noteriale të datës 04.06.2016, në të cilën ai, bashkëshortja – znj. K. Ç. – si dhe nëna e bashkëshortes – znj. M. Ç. – kanë deklaruar se në vitin 2015, kanë marrë hua nga Sh. dhe M. Ç. shumën prej 14.000.000 lekësh, i cili ishte fond i përfituar nga shpronësimi i objektit restorant “{***}”, në {***}, Pogradec, dhe se këto të ardhura u përdorën prej subjektit dhe bashkëshortes së tij për blerjen e dy njësive tregtare në Tiranë. Gjithashtu, deklarojnë se në datën 04.06.2016, i është shlyer znj. M. Ç. e gjithë shuma prej 14.000.000 lekësh, të cilat ishin dhënë hua prej saj dhe bashkëshortit, në vitin 2015.

Ndërsa, nëpërmjet deklaratës¹¹ noteriale të datës 29.10.2016, znj. M. Ç. ka deklaruar se, së bashku me bashkëshortin, të ndjerin Sh. Ç., i kanë dhënë hua vajzës së tyre K. Ç. dhe dhëndrit Ken Dhima, shumën prej 14.700.000 lekësh në vitin 2015, nga të cilat shuma prej 14.000.000 lekësh nëpërmjet bankës dhe 700.000 lekë *cash* për blerjen e dy ambienteve që ato dëshironin të blinin. Burimi i të ardhurave është përfituar nga shpronësimi i objektit në pronësi të tyre, të ndodhur në fshatin {***}, Pogradec. Nga kjo shumë, vlera prej 14.000.000 lekësh i është shlyer në vitin 2016, pas marrjes së një kredie nga vajza dhe dhëndri (subjekti i rivlerësimit).

Komisioni konstatoi mospërputhje në deklaratat noteriale të cituara më sipër, lidhur me shumën prej 700.000 lekësh, të marrë hua në vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, për

⁹ Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.08.2015.

¹⁰ Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2016.

¹¹ Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2016.

të cilat Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, por ai nuk dha shpjegime edhe pas marrjes së rezultateve të hetimit.

Komisioni vlerësoi se personat e tjerë të lidhur (prindërit e bashkëshortes së subjektit) kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huasë gjatë vitit 2015, në vlerën prej 14.000.000 lekësh, konfirmuar kalimi i kësaj shume nëpërmjet transfertës bankare.

14.5 Lidhur me shumën prej 7.000.000 lekësh që ka shërbyer si burim i krijimit të kësaj pasurie, pjesë e huasë së pretenduar nga subjekti si të marrë nga prindërit e bashkëshortes, ku në deklaratën noteriale të datës 29.10.2016, cituar në paragrafin më sipër, nëna e bashkëshortes së subjektit ka deklaruar se kjo shumë ka si burim të ardhurat e përfituara si rrjedhojë e shpronësimit të objektit bar-restorant “{***}”. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se:

- Më datë 16.04.2015, në llogarinë bankare të personit tjetër të lidhur, z. Sh. Ç., në Raiffeisen Bank, është kredituar nëpërmjet transfertës, shuma prej 14.712.113 lekësh.
- Në datën 18.06.2015, nga llogaria bankare e z. Sh. Ç., transferohet në llogarinë e vajzës së tij, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, shuma prej 14.000.000 lekësh.
- Në datën 22.06.2015, z. Sh. Ç. transferon në llogari të bashkëshortes së tij shumën prej 699.690 lekësh.
- Znj. M. Ç., pas transfertës së z. Sh., ka kaluar në depozitë shumën prej 703.320 lekësh, e përbërë nga balanca e llogarisë para transfertës dhe shumës prej 699.690 lekë të transfertës së ardhur nga z. Sh. Ç..
- Në datën 23.06.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kaluar në llogarinë bankare të noteres shumën prej 7.500.000 lekësh, me përshkrimin “Blerje apartamenti [...]”.

14.6 Për rrjedhojë, referuar dokumentacionit të administruar në dosje, nga të dhënat në llogarinë bankare të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, shuma prej 700.000 lekësh, pjesë e të ardhurave të krijuara nga shpronësimi i ndërtesës në qytetin e Pogradecit, ka qenë gjendje në llogarinë e vjehrrës së subjektit, e vendosur në formën e depozitës në datën 22.06.2015, për këtë arsye, në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, në Kolegj nuk u konsiderua shuma prej 700.000 lekësh, e pretenduar si e marrë hua në formën e likuiditetit *cash* nga prindërit e bashkëshortes së tij. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të vitit 2015, shumën prej 700.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si huamarrje nga prindërit e bashkëshortes dhe që ka shërbyer si burim për blerjen e njësisë tregtare në {*}.**

14.7 Lidhur me shumën prej 500.000 lekësh, si pjesë e të ardhurave të përfituara nga qiradhënia e dyqanit z. A. Ç., të cilat sipas deklarimit në DIPP-në e vitit 2015, kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë burim në deklaratën *vetting*. Në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet [...]”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiraja sipas kontratës së lidhur me subjektin “A. Ç.” Person Fizik, nga data 01.05.2015 deri në datën 31.12.2015, shumën prej 1.200.000 lekësh.

Në analizimin e kësaj marrëdhënieje, Komisioni evidentoi faktin se, bazuar në kontratën¹² e datës 16.07.2015, subjekti “A. Ç.” Person Fizik ka marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, ambientin në pronësi të tyre, të llojit “njësi shërbimi” me sip. prej 44 m², me qira mujore në vlerën prej 172.500 lekësh, dhe se në këtë kontratë përcaktohet se afati i saj ka filluar në datën 01.05.2015. Nga verifikimi në faqen online të QKB-së, Komisionit i rezultoi se subjekti tregtar “A. Ç.” Person Fizik e ka regjistruar aktivitetin në datën 11.11.2015. Komisioni, siç është referuar edhe më sipër, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ende kishte detyrime të pashlyera ndaj A. Ç., në shumën prej 2.000.000 lekësh, për huanë e pretenduar si të marrë prej tij në vitin 2005.

14.8 Komisioni i ka kërkuar informacion¹³ Drejtorisë Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Tiranë, për të dhënat mbi subjektin tregtar “A. Ç.” Person Fizik, duke kërkuar të gjitha të ardhurat dhe detyrimet tatimore të paguara përgjatë aktivitetit të tij tregtar. Në përgjigje¹⁴, DRT-ja ka sqaruar situatën financiare të këtij subjekti tregtar, duke evidentuar se tatimi në burim është paguar vetëm për periudhën shkurt-maj 2017.

Sipas kontratës së qirasë datë 16.07.2015, të administruar në dosje, qiramarrësi “A. Ç.” Person Fizik ka marrë me qira njësinë në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Afati i qirasë është përcaktuar nga data 01.05.2015 deri më 30.04.2020, me pagesë mujore 172.500 lekë, duke përfshirë këtu edhe tatimin në burim prej 15%, që do të paguhet nga qiramarrësi dhe do të mbahet nga ky i fundit në pagesat e qirasë për çdo muaj. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se pagesa e qirasë nga z. A. Ç. është kryer në favor të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet llogarive bankare dhe në zbatim të kushteve të kontratës së qirasë të lidhur ndërmjet tyre.

14.9 Komisioni, me rezultatet e hetimit, i kaloi barrën e provës subjektit, për të dhënë shpjegime e depozituar prova të reja, për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së qirasë me subjektin “A. Ç.” Person Fizik, prej datës 01.05.2015 e në vijim. Subjekti nuk ka dorëzuar prapësime dhe as prova. Komisioni, në kuadrin e dyshimeve të ngritura për marrëdhënien e qiradhënies mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Ç., vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura para datës së nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe para regjistrimit të adresës së dyqanit si adresë sekondare e tatimpaguesit “A. Ç.” Person Fizik, duke arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti të provojë ligjshmërinë e shumës prej 500.000 lekësh, të pretenduar nga kjo marrëdhënie qiraje.

14.10 Në vijim të sa më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e qirasë, duke parashikuar në të fillimin e kësaj marrëdhënieje rreth dy muaj para lidhjes së kontratës së qirasë. Nga të dhënat e QKB-së së personit fizik të qiramarrësit, rezultoi se adresa e njësisë së marrë me qira, është regjistruar më datë 11.11.2015, pra katër muaj pas lidhjes së kontratës, ndërkohë që nga DRT Tiranë informohet se ky subjekt tregtar ka paguar tatim në burim për qiranë vetëm për periudhën shkurt-maj 2017, duke mos rezultuar pagesa të detyrimeve tatimore në vitin 2015-2016. Nga dokumentacioni i administruar nga DRT Tiranë (paragrafi 14.8 më sipër), si dhe

¹² Kontrata e qirasë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 16.07.2015.

¹³ Shkresa e Komisionit nr. {***} prot., datë 27.05.2021.

¹⁴ Shkresa e DRT-së nr. {***} prot., datë 08.06.2021.

të dhënat e QKB-së cituar më sipër, Kolegji vlerësoi se është provuar marrëdhënia e qirasë, si dhe e ardhura e subjektit të rivlerësimit, e pretenduar si e krijuar nga kjo marrëdhënie që fillon nga data 01.05.2015, sipas parashikimit të përcaktuar në kontratë. Gjithashtu, Kolegji konstaton se në kontratën e qirasë, ishte parashikuar se detyrimi i tatimit në burim do të paguhej nga qiramarrësi. Subjekti i rivlerësimit ka përfutur qiranë e këtij objekti nga qiradhënësi, nëpërmjet llogarisë bankare, nga verifikimi i së cilës ka rezultuar se qiramarrësi i ka kaluar shumën neto të parashikuar në kontratë për likuidimin e qirasë, e cila rezulton në shumën rreth 160.000 lekë në muaj, pasi ka hequr pjesën e tatimit në burim si pagesë e detyrimit tatimor të marrë përsipër nga qiramarrësi në kontratë.

14.11 Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerëson se, sipas parashikimeve kontraktore, ku qiradhënësi është përjashtuar nga pagesa e detyrimit tatimor, konsideruar edhe faktin se në bankë ka përfutur vlerën neto të qirasë, pra ka përfutur qiranë e zhveshur nga tatimi në burim, edhe nëse nuk është paguar tatimi në burim nga qiramarrësi, si detyrim i parashikuar dhe dakordësuar ndërmjet palëve në kontratën e qirasë, subjekti i rivlerësimit duket se ka qenë në kushtet e mirëbesimit për kryerjen e këtyre pagesave. Për këtë arsye, në Kolegji, shuma prej 500.000 lekësh, e përfutur nga dhënia me qira e kësaj njësie tregtare, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit se ka shërbyer si burim i krijimit të pasurisë objekt kontrolli, rezultoi se është krijuar me burime financiare të ligjshme, për rrjedhojë kjo shumë u përfshi në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

- 15. Lidhur me dy pasuritë e llojit “garazh”,** me sipërfaqe përkatësisht nga 18,2 m² dhe 18,9 m², të ndodhura në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se burimi i krijimit të këtyre pasurive kanë qenë të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si gjyqtarë, dhe të ardhurat nga dhënia me qira vëllait të tij, të pasurisë “njësi shërbimi me sip. 46 m²” e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se burimet e krijimit të këtyre pasurive janë të provuara me prova shkresore të vërtetuara nga noteri publik, të paraqitura prej tij bashkë me deklaratën *vetting*. Subjekti shprehet se është i paqartë se për cilat të ardhura Komisioni mendon se nuk provohet burimi, kur të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si edhe të ardhurat nga qiraja janë të provuara, dhe për to janë paguar të gjitha detyrimet tatimore. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e blerjes së këtyre pasurive është përfshirë në mënyrë abuzive në dy analiza të ndryshme të kryera nga Komisioni, si në atë të periudhës 01.01.2015 - 10.04.2015 dhe në analizën e periudhës 01.01.2015 - 30.09.2015.

15.1 Konkluzioni i Komisionit për këto pasuri, në vendim, është: *Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurive të mësipërme, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*

15.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se këto pasuri nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: (i) garazh me sipërfaqe 18,9 m²; dhe (ii) garazh me sipërfaqe 18,2 m², të ndodhura në rrugën “{***}”, Tiranë, të blera më datë 10.04.2015, nga shoqëria “{***}” ShPK, me vlerë prej 4.500 eurosh secili. Subjekti ka deklaruar se zotëron ½ pjesë takuese të këtyre pasurive. Si burim krijimi, ka deklaruar: (i) të ardhurat nga

paga si gjyqtar; (ii) të ardhurat nga paga e bashkëshortes si gjyqtare; dhe (iii) të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit në rrugën “{***}”, Tiranë (kontrata e qirasë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.11.2013, e lidhur me z. E. Dh.).

15.3 Nga hetimi administrativ në Komision, rezultoi se, me kontratën kontratën e shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.04.2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A. Ç.) kanë blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, dy pasuri të llojit: (i) garazh me sip. 18,9 m², me nr. pasurie {***}; dhe (ii) garazh me sip. 18,2 m² me nr. pasurie {***}, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë për çmimin në total prej 9.000 eurosh, e konvertuar në shumën prej 1.262.520 lekësh (secili me çmim prej 4.500 eurosh – konvertuar në shumën 631.260 lekë). Të dyja pasuritë (garazhet) janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij më datë 14.04.2015. Referuar nenit 5 të kontratës së shitblerjes, blerësit e kanë paguar paraprakisht të gjithë çmimin blerjes në shumën prej 9.000 eurosh, sipas mandatit me nr. {***}, lëshuar nga Raiffeisen Bank. Gjithashtu, rezulton se z. A. Ç., më datë 10.04.2015, ka depozituar *cash* shumën prej 9.000 eurosh në Raiffesien Bank, dhe e ka kaluar këtë shumë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “Për Ken Dhima derdh A. Ç., sipas kontratës nr. rep. {***} dhe kol. {***}, datë 10.04.2015, garazh 1, garazh 2”.

15.4 Sa i përket burimit të krijimit të këtyre pasurive, në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga qiradhënia e dyqanit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nëpërmjet të cilit Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit përse nuk janë deklaruar këto pasuri në deklaratën periodike të vitit 2015, si dhe burimi i krijimit të tyre, subjekti ka sqaruar se si burim për blerjen e garazheve kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Gjithashtu, ka sqaruar se pagesat janë bërë *cash* nëpërmjet shtetasit A. Ç., por, në kushtet që nuk ka më marrëdhënie shoqërore me të, i duhet të kërkojë informacion te shoqëria ndërtuese. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke konstatuar mospërputhje në deklaratimet e tij lidhur me burimin e krijimit të pasurive objekt vlerësimi.

15.5 Nga verifikimi i DIPP-ve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, rezulton se, për periudhën 2003 – 2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar kursime në formën e likuiditeteve *cash*, me burim krijimi të ardhurat e tyre nga pagat. Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2014, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën prej 1.400.000 lekësh, me përshkrimin: “Para *cash* jashtë sistemit bankar, si rezultat i qirasë së lokalit në pronësinë timen dhe të bashkëshortes”, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se lidhen me marrëdhënien e qiradhënies me z. E. Dh.. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash*.

15.6 Siç është cituar edhe në paragrafin 13.5 më sipër, me kontratën e datës 18.11.2013, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë vëllait të tij (si individ) me qira njësinë e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, për vlerën 150.000 lekë në muaj. Nga verifikimi në QKB, rezulton se në datën 21.11.2013, është regjistruar subjekti “E. Dh.” Person Fizik, për ushtrimin e aktivitetit “Bar-kafe”, me adresë ushtrimi aktiviteti në Tiranë, rruga “{***}”. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti

i rivlerësimit në ILDKPKI, lidhur me këtë marrëdhënie qiraje, duket se për vitin 2014, është mbajtur, deklaruar dhe paguar tatim në burim nga subjekti tregtar “E. Dh.” Person Fizik, në shumën prej 180.000 lekësh, për vlerën e qirasë vjetore të deklaruar në shumën prej 1.800.000 lekësh. Ndërsa, në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja prej lokalit në pronësi sipas kontratës së qirasë me z. E. Dh., nga data 01.01.2015 deri më datë 30.04.2015, në shumën prej 600.000 lekësh. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitin 2015. Komisioni ka vlerësuar se në kushtet kur kontrata e qiradhënies është lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit E. Dh. si individ, referuar legjislacionit tatimor (ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, të Ministrit të Financave, dalë në zbatim të tij), përfituesi i të ardhurave (subjekti i rivlerësimit) është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor, tatimin përkatës për të ardhurat e realizuara. Për këtë arsye, Komisioni nuk i përfshiu në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për vitin 2015, si të krijuara nga dhënia me qira e njësisë së shërbimit z. E. Dh.. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Gjithashtu, Komisioni konkludoi se gjendja *cash* e deklaruar në DIPP-në e vitit 2014, nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e këtyre pasurive, për sa kohë nuk është deklaruar pakësimi i saj në DIPP-në e vitit 2015. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiare për periudhën 01.01.2015 – 10.04.2015, data që është lidhur kontrata për blerjen e pasurive, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e dy garazheve, për një diferencë negative në shumën (-)1.515.198 lekë.

15.7 Në analizë të sa më sipër, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto pasuri (garazhet) në DIPP-në e vitit 2015, duke i deklaruar vetëm në deklaratën *vetting*. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se ka mospërputhje të burimit të krijimit të këtyre pasurive të deklaruar në deklaratën *vetting*, krahasuar me sqarimet e dhëna për burimin e krijimit të tyre në pyetësin nr. 2 të Komisionit (paragrafi 15.4 më sipër). Edhe pse iu kërkuan sqarime nga Komisioni për këto konstatime, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime.

15.8 Lidhur me të ardhurat nga dhënia me qira vëllait të subjektit, të njësisë në rrugën “{***}”, Tiranë, të cilat, sipas deklarimit në DIPP-në e vitit 2015, janë në shumën 600.000 lekë për periudhën nga 01.01.2015 deri më datë 30.04.2015, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor për të provuar se janë paguar detyrimet tatimore për shumën e përfutur nga qiradhënia e njësisë. Në kontratën e qirasë së lidhur me vëllain e tij, është evidentuar fakti se objekti i jepet me qira z. E. Dh. me qëllim ushtrimin prej tij të aktivitetit privat me destinacion “Bar-kafe”. Marrëdhënia e qiradhënies është materializuar në një kontratë të lidhur mes dy individësh, ku z. E. Dh. paraqitet si qiramarrës individ dhe jo qiramarrës subjekt tregtar, rast në të cilin ligji¹⁵ i kohës do ta ngarkonte me detyrimin e agjentit të mbajtjes së tatimit në burim. Nga

¹⁵ Neni 33 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, aktualisht i shfuqizuar, parashikon: “1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, si dhe çdo subjekt

verifikimi në QKB, rezultoi se në datën 21.11.2013 është regjistruar subjekti “E. Dh.” person fizik, për ushtrimin e aktivitetit “Bar kafe”, me adresë ushtrimi aktiviteti në Tiranë, rruga “{***}”, çka provon se qiramarrësi e ka deklaruar si adresë të aktivitetit privat njësinë e marrë me qira.

15.9 Nga verifikimi i përcaktimeve kontraktuale, rezulton se palët nuk kanë parashikuar në kontratën e qirasë përkatësinë e detyrimeve tatimore për qiranë, por është përcaktuar vetëm çmimi i qirasë në vlerën 150.000 lekë në muaj, pa përcaktuar nëse është bruto apo neto. Nga DIPP-ja e vitit 2015, ku subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga qiraja janë në shumën 600.000 lekë për periudhën e cituar në paragrafin më sipër, del qartë se pagesa e qirasë është likuiduar në masën bruto nga vëllai i subjektit. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhurën nga qiraja në masën bruto (150.000 lekë $\times$ 4 muaj = 600.000 lekë), pasi deklarimi i kësaj të ardhure në DIPP-në e vitit 2015 i korrespondon parashikimit të çmimit të saj të dakordësuar ndërmjet palëve në kontratën e qirasë, duke krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni se vlerën e qirasë e merrte të plotë, çka konfirmon keqbesimin e tij në mospërmbushjen e detyrimit sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, aktualisht i shfuqizuar, për pagesën e tatimit për të ardhurën e krijuar nga qiradhënia. Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, por, siç është sqaruar edhe më sipër në këtë vendim, subjekti nuk ka dorëzuar prapësime dhe prova për rezultatet e hetimit, si rrjedhojë nuk provoi se të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e njësisë, nuk përmbushin standardin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit të ardhura të ligjshme, për qëllime të këtij ligji, do të konsiderohen ato që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

15.10 Gjithashtu, lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2014, për të cilën Komisioni ka vlerësuar se lidhen me të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting*, se këto të ardhura kanë shërbyer si burim për blerjen e garazheve. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes së *cash*-it. Edhe në pyetësin nr. 2, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit sqaroi se, si burim për blerjen e garazheve, kanë shërbyer pagat e tij dhe të bashkëshortes, nga funksioni si gjyqtarë, pa përmendur si burim të ardhurat nga dhënia e njësisë me qira, mospërputhje këto, të cilat e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me përfshirjen e të ardhurave nga qiraja si burime të krijimit të pasurive objekt kontrolli.

15.11 Në përfundim të sa më sipër, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të sqarojë mospërputhjen e rezultuar në deklaratën *vetting* me përgjigjet e pyetësit nr. 2 të Komisionit,

tjetër, i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, mban në burim tatimin, në masën 15 për qind, për pagesat e mëposhtme:

- a) dividendët, përveç dividendëve të përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 34 të këtij ligji;*
- b) ndarjet e fitimit, përveç ndarjeve të fitimit të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 34 të këtij ligji;*
- c) interesat, përveç interesave të bonove të thesarit dhe të letrave të tjera me vlerë, të emetuara nga Këshilli i Ministrave para datës 1 janar 1999, të përcaktuara në paragrafin e tretë të nenit 34 të këtij ligji;*
- d) pagesat për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale;*
- d) pagesat për shërbime teknike dhe pagesat për menaxhim, si dhe pagesat për qiratë [...]”.*

lidhur me burimet që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive. Gjithashtu, për të ardhurat në shumën 600.000 lekë, të krijuara nga dhënia me qira e njësisë në rrugën “{***}”, e të deklaruara në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit nuk provoi se për to janë paguar detyrimet tatimore për t’u konsideruar si burime financiare të ligjshme, për rrjedhojë gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit që ato të mos përfshihen në analizën financiare të subjektit për periudhën 01.01.2015 - 10.04.2015. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* edhe të ardhurat nga qiraja, Kolegji verifikoi edhe mundësinë e përdorimit të gjendjes *cash* të deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2014, dhe i rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kësaj gjendjeje *cash* në DIPP-në e vitit 2015, si rrjedhojë Kolegji çmoi se këto likuiditete nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi të pasurive objekt vlerësimi. Nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk mund të përballonin blerjen e këtyre pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për diferencën negative në shumën (-)1.515.198 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

16. ***Lidhur me pasurinë “njësi shërbimi” me sipërfaqe 47 m²***, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë pasuri e ka marrë në dorëzim të papërfunduar, në gjendjen karabina dhe se Komisioni ka konsideruar në mënyrë të qëllimshme se shuma e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit është në vlerën 246.429 euro. Subjekti sqaron se ka deklaruar në deklaratat e pasurisë shumën e shlyer, si dhe shumën e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, diferenca negative në shumën 15.000.000 lekë është e pavërtetë, e cila vjen si pasojë e përlllogaritjes së vlerës së pasurisë sikur ajo të ishte e përfunduar dhe jo karabina, vlerësim i bërë *apriori* nga Komisioni. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk i vuri në dispozicion dosjen e provave dhe fotot që ka administruar nuk kanë vlerën e provës, sepse duhet të ishin marrë në prani të subjektit të rivlerësimit. Subjekti sqaron në ankim se këto foto i përkasin vitit 2021, ndërkohë që pasuria është marrë në dorëzim disa vite më parë. Subjekti pretendon se burimet e krijimit të kësaj pasurie janë treguar plotësisht në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*, duke paraqitur të gjitha provat e duhura në formën e kërkuar nga ligji. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare e pasqyruar në vendim, për këtë pasuri, nuk është e vërtetë.

16.1 Komisioni, në vendim, ka konkluduar se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

16.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Njësi shërbimi me sip. 188,18 m² e përbërë përkatësisht nga pasuritë me sip. 47,23 m², 42,62 m² dhe 98,33 m², të ndodhura në rrugën “{***}” e vërtetuar me kontratën e prenotimit me nr. {***} rep., {***} kol., datë 16.07.2015, e lidhur ndërmjet sipërmarrësit shoqëria “{***}” ShPK dhe porositësit Ken Dhima e K. Ç.. Vlera 246.429 euro nëse merret në dorëzim e përfunduar plotësisht dhe 105.500 euro nëse merret në gjendje karabina”. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e tij dhe bashkëshortes nga paga si gjyqtarë, kredia e marrë nga banka Societe Generale Albania në shumën 21.000.000

lekë, të ardhurat nga qiraja e njësisë së shërbimit në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas kontratës së qirasë të lidhur me shtetasin A. Ç., si dhe të ardhurat nga qiraja e ambientit njësi shërbimi, sipas kontratës së lidhur nga bashkëshortja e subjektit dhe shoqërisë Posta Shqiptare ShA.

Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, për blerjen e njësisë së shërbimit sipas kontratës. Detyrimi i pashlyer është në shumën 196.429 euro nëse merret në dorëzim e përfunduar dhe 55.000 euro nëse do të merret në dorëzim karabina.

16.3 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar ambient me sipërfaqe 235,18 m² (i përbërë nga katër njësi), në rrugën “{***}”, me kontratë prenotimi, pronë e tipit karabina me leje ndërtimi. Kontrata e parë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015, dhe kontrata e dytë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015. Paguar totalisht kontrata e parë. Shuma: 7.500.000 lekë. Burimi është VKM-ja për shpronësim me nr. 909, datë 22.12.2014, të bar-restorant “{***}”. Kontrata e dytë e palikuiduar.

Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar detyrimin në shumën 246.429 euro ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, sipas kontratës. Ky detyrim, sipas subjektit, fillon në shtator të vitit 2015 dhe mbaron në gusht të vitit 2017.

Në DIPP-në e vitit 2016, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë e fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Detyrimi ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, lidhur me blerjen e një njësie shërbimi e vërtetuar me kontratën e prenotimit me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015 (karabina). Shlyer vlera e përshkruar (50.000 euro) nëpërmjet bankës nga kredia bankare e marrë. Detyrimi i mbetur në vlerën 55.000 euro”.

16.4 Nga hetimit administrativ në Komision rezultoi se me kontratën¹⁶ e prenotimit të datës 16.07.2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur nga shoqëria “{***}” ShPK, në objektin që po ndërtonte kjo shoqëri në rrugën “{***}”, Tiranë, tre pasuri të llojit njësi shërbimi, si vijon:

- i) njësi shërbimi me sipërfaqe 47,23 m², dyqani nr. {***}, Seksioni B;
- ii) njësi shërbimi me sipërfaqe 42,62 m², dyqani nr. {***}, Seksioni B;
- iii) njësi shërbimi me sipërfaqe 98,33 m², dyqani nr. {***}, Seksioni B.

Në këtë kontratë (neni 1) është përcaktuar se vlera totale e shitblerjes dhe prenotimit për këto pasuri është në shumën 246.429 euro. Kontrata parashikon se në rast se palët bien dakord në vijim ndërmjet tyre që ambientet e mësipërme do të dorëzohen në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës, çmimi total për këto njësi të prenotuara do të jetë 105.000 euro, dhe kjo do të vërtetohet me një akt të llojit deklaratë noteriale ndërmjet palëve.

16.5 Sipas kontratës së prenotimit të sipërcituar, mënyra e likuidimit të pasurive është përcaktuar si në vijim:

- i) kësti i parë, në vlerën prej 50.000 eurosh do të likuidohet brenda muajit shtator 2015;
- ii) kësti i dytë, në vlerën prej 50.000 eurosh do të likuidohet brenda muajit mars 2016;
- iii) kësti i tretë, në vlerën prej 50.000 eurosh do të likuidohet brenda muajit nëntor 2016;

¹⁶ Kontrata e prenotimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015.

iv) kësti i katërt, në vlerën prej 50.000 euro do të likuidohet brenda muajit prill 2017;
v) kësti i pestë dhe i fundit, në vlerën prej 46.429 eurosh do të likuidohet brenda muajit gusht 2017. Gjithashtu, në këtë kontratë përcaktohet se likuidimi i të gjithë shumave të mësipërme do të bëhen nga pala porositëse në llogaritë e sipërmarrësit ndërtues “{***}” ShPK, pranë bankave të nivelit të dytë.

Komisioni kreu analizën e treguesve financiare për periudhën 01.01.2015 – 30.09.2015, sipas përcaktimeve të kontratës së prenotimit të datës 16.07.2015, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës së kështit të parë në shumën prej 50.000 eurosh për blerjen e tre pasurive objekt vlerësimi. Sipas kësaj analize, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të paguar kështin e parë prej 50.000 eurosh për një diferencë negative në shumën (-) 15.105.273 lekë. Për këtë arsye, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të konstatuara.

16.6 Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me këto tre njësi shërbimi, i cili ka sqaruar se pasuritë janë blerë karabina në shumën 105.000 euro, dhe se të gjitha pagesat janë bërë nëpërmjet noterit R. R., por nuk e mban mend nëse janë paguar nëpërmjet bankës, për shkak se nuk ka kohë të mjaftueshme për të marrë informacionin e duhur. Gjithashtu, ka deklaruar se burimi i krijimit të këtyre pasurive është ai i referuar në DIPP-të vjetore dhe në deklaratën *vetting*, si dhe se nuk ka kryer asnjë investim në këtë pasuri.

Referuar dokumentacionit të OTP Bank, rezulton se në datën 09.05.2016 ndërmjet bankës Societe Generale Albania (sot OTP Bank), subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur është lidhur kontrata¹⁷ e kredisë bankare afatgjatë, për dhënien hua të shumës 21.000.000 lekë, me objekt investimin në pasuri të paluajtshme. Si kushte lëvrimit në këtë kontratë janë parashikuar: (i) të paraqitet para disbursimit konfirmimi nga shitësi për shumën totale të transaksionit të tri njësive që po blihen dhe të cilësohet statusi i tyre karabina; (ii) fondet e kredisë në shumën prej 14.000.000 lekësh të kalojnë me transfertë në llogarinë e huadhënësve (prindërve të bashkëshortes së subjektit); si dhe (iii) shuma prej 7.000.000 lekësh të kalojë në llogari të shitësit/noterit.

16.7 Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare dyemërore të subjektit dhe bashkëshortes së tij në OTP Bank rezultoi se kredia është disbursuar në datën 18.05.2016 në vlerën 21.000.000 lekë. Në datën 19.05.2016 shuma prej 7.000.000 lekësh është transferuar në llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin “Kalim fondi sipas kontratës së prenotimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015”.

Pjesa e mbetur prej 13.851.000 lekësh, pas pagesave të vlerësimeve dhe komisioneve, është transferuar në datën 23.05.2016 në llogarinë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur në BKT, dhe në vijim e gjithë shuma është tërhequr *cash* nga subjekti dhe personi i lidhur në tre këste, si vijon: (i) në datën 27.05.2016 tërhequr shuma prej 8.000.000 lekësh; (ii) në datën 30.05.2016 tërhequr shuma prej 4.000.000 lekësh; si dhe (iii) në datën 03.06.2016 tërhequr shuma 1.850.000 lekë.

¹⁷ Kontrata e kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.05.2016.

16.8 Në dokumentacionin e administruar në dosje, gjendet deklarata noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.05.2016, sipas së cilës, sipërmarrësi “{***}” ShPK dhe porositësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, deklarojnë se kanë nënshkruar ndërmjet tyre një kontratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015, për prenotimin, nga pala porositëse, të tri njësive. Pala sipërmarrëse deklaron se është dakord që t’i dorëzojë palës porositëse ambientet e sipërcituara në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës, çmimi total për këto njësi të prenotuara do të jetë 105.000 (njëqind e pesë mijë) euro.

Sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.06.2016, sipërmarrësi “{***}” ShPK dhe subjekti i rivlerësimit e bashkëshortja e tij deklarojnë se bazuar në negociatat e zhvilluara midis palëve në marrëdhënie (për shkak se nuk është rënë dakord për disa volume punimesh, të cilat ishte rënë dakord verbalisht për t’u kryer), palët bien dakord të anulojnë deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.05.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve objekt i kontratës së prenotimit, duke deklaruar se këtë gjë do ta përcaktojnë në momentin e marrjes në dorëzim të ambienteve. Pra, kjo deklaratë revokon deklaratën noteriale të sipërcituar në këtë paragraf.

16.9 Sipas deklaratës tjetër noteriale të administruar në dosje, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2018, shoqëria e ndërtimit dhe subjekti i rivlerësimit e bashkëshortja e tij deklarojnë se në datën 20.01.2018, shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK i dorëzoi subjektit dhe bashkëshortes ambientin në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës, për çmimin total 105.000 euro, sipas kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015, për prenotimin e të tri njësive. Në datën 05.10.2018 është nënshkruar kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., për shitblerjen e njësive objekt kontrolli, sipas së cilës përcaktohet çmimi total i të tri njësive në vlerën prej 105.000 eurosh, si dhe 7.500.000 lekë për njësinë prej 47 m².

Rezulton se me anë të deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.11.2019, shoqëria “{***}” ShPK dhe subjekti i rivlerësimit e bashkëshortja e tij deklarojnë se me njëri-tjetrin kanë nënshkruar dy kontrata prenotimi, të parën¹⁸ më datë 16.07.2015, për njësinë¹⁹ e numërtuar me nr. {***} me vlerë 7.500.000 lekë, si dhe kontratën e prenotimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015, për marrëveshje ndërtimi, për tre njësi të numërtuara me {***}, {***} dhe {***} me vlerë 246.429 euro. Gjithashtu, në deklaratë citohet: “Sot përpara noterit, palët sa më sipër deklarojnë se shuma në total për blerjen e katër ambienteve (4-njësive) është dorëzuar në gjendjen karabina dhe pa rifinitura. Pra, vlera e tyre përfundimisht në total është në shumën 105.000 euro, shumë e cila është shlyer në total sipas mandateve dhe palët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit”. Kolegji konstaton se në këtë deklaratë noteriale ka mospërputhje në deklaratimet e bëra nga palët, pasi në të referohet fakti se në vitin 2015 janë lidhur dy kontrata sipërmarrje, e para për njësinë 47 m², blerë me çmimin 7.500.000 lekë, si dhe me kontratën e dytë të sipërmarrjes janë blerë tre njësi, për çmimin 246.429 euro, ndërsa në vijim të deklaratës deklarohet se janë katër njësi të blera me vlerë 105.000 euro në gjendjen karabina, nga shoqëria “{***}” ShPK.

¹⁸ Kontrata e prenotimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2015 e lidhur për njësinë me sip. 47 m².

¹⁹ Kjo pasuri është analizuar nga Komisioni dhe ka arritur konkluzionin në paragrafin 45.7 të vendimit, se subjekti ka nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën vetting dhe për të cilin subjekti nuk ka ngritur shkaqe ankimi.

16.10 Komisioni i ka kërkuar informacion²⁰ të detajuar shoqërisë “{***}” ShPK, lidhur me objektin e ndërtuar prej saj, prenotimin, pagesën e çmimit, si edhe mbi mënyrën e dorëzimit të tri njësive objekt vlerësimi. Shoqëria dërgoi²¹ dokumentacion lidhur me këto njësi shërbimi, përfshirë foto, kontrata e planimetri të ndërtimit, por nuk informoi dhe nuk depozitoi dokumentacion provues në Komision për momentin e kolaudimit të objektit dhe për gjendjen në momentin e dorëzimit të tri njësive të shërbimit. Nuk u dërgua informacion as mbi mënyrën dhe periudhën e likuidimit të çmimit për blerjen e këtyre njësive, dhe as për faktin nëse nga porositi, z. Ken Dhima, janë kryer punime shtesë mbi to. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga shoqëria e ndërtimit, rezultojnë disa foto, në të cilat duket se për njësitë janë përfunduar punimet e plota, përfshirë dhe rifiniturat (muret e suvatuara e të lyera, pllakat në tokë të vendosura, si dhe dyert me vetrata xhami).

Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se nuk provohen pretendimet e subjektit se këto tre njësi janë marrë në dorëzim karabina dhe, si rrjedhojë, çmimi total i tyre nuk është 105.000 euro. Për këtë arsye, në analizën financiare paraprake, Komisioni reflektoi si çmim të blerjes të tri njësive objekt vlerësimi, shumë prej 246.429 eurosh, si dhe i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën. Subjekti nuk u përgjigj për rezultatet e hetimit dhe nuk dorëzoi dokumentacion provues.

16.11 Në analizë të sa më sipër, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e prenotimit në vitin 2015, duke parashikuar në të pagesën e kësteve për likuidimin e pasurive objekt kontrolli (paragrafi 16.5 më sipër), këste të cilat nuk iu saktësua periudha dhe as shuma e paguar. Referuar kësaj kontrate janë parashikuar pagesat, duke përcaktuar që njësitë të jenë të përfunduara dhe me një çmim në total prej 246.429 eurosh, si dhe duke parashikuar, gjithashtu, që nëse palët do të kenë dakordësi në të ardhmen për ta dorëzuar objektin në gjendje karabina, çmimi në total për të tri njësitë do të jetë në vlerën 105.000 euro. Subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se Komisioni i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve, nuk dorëzoi akte për të provuar pretendimin e tij se këto pasuri janë blerë në gjendjen karabina. Vetëm në pyetësin nr. 2 të Komisionit (paragrafi 16.6 më sipër), subjekti ka deklaruar që janë blerë në gjendjen karabina, por nuk mban mend nëse çmimi është paguar në bankë apo *cash*, si dhe nuk dorëzoi asnjë dokumentacion ligjor për të provuar pretendimet e tij.

16.12 Në deklaratën noteriale të nënshkruar nga subjekti dhe shoqëria e ndërtimit, më datë 13.05.2016 (paragrafi 16.8 më sipër), palët kanë deklaruar se kanë rënë dakord që objektet (tri njësitë) të merren në dorëzim nga blerësi në gjendjen karabina. Pas rreth një muaji, të njëjtat palë kanë nënshkruar deklaratën tjetër noteriale të datës 15.06.2016 (paragrafi 16.8 më sipër), sipas së cilës është revokuar deklarata noteriale e datës 13.05.2016, për përcaktimin e mënyrës së dorëzimit të ambienteve objekt i kontratës së prenotimit, duke deklaruar se këtë do ta përcaktojnë në momentin e marrjes në dorëzim të ambienteve. Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezultoi se më datë 04.06.2018, shoqëria e ndërtimit dhe subjekti i rivlerësimit e bashkëshortja e tij nënshkruajnë një deklaratë tjetër noteriale (paragrafi 16.9 më sipër), në të cilën deklarojnë se

²⁰ Shkresë nr. {***} prot., datë 27.05.2021, e Komisionit.

²¹ Dokumentacioni i depozituar nga shoqëria, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.06.2021.

shoqëria e ndërtimit i dorëzoi subjektit dhe bashkëshortes së tij ambientin në gjendje karabinaje pa punime të rifiniturës, për çmimin total 105.000 euro. Në datën 05.10.2018 rezultoi se është nënshkruar kontrata për shitblerjen e njërive, sipas së cilës përcaktohet çmimi total i të tri njërive në vlerën prej 105.000 eurosh, si dhe 7.500.000 lekë për njësinë prej 47 m². Në këtë kontratë është parashikuar se blerësi e ka likuiduar plotësisht shitësin dhe ky i fundit i ka marrë shumat e përcaktuara më sipër dhe nuk do të ketë pretendime të në ardhmen. Subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi dokumentacion financiar/mandate për të provuar mënyrën e likuidimit të këtyre pasurive. Gjithashtu, edhe në informacionin e dërguar Komisionit nga shoqëria e ndërtimit nuk gjenden mandate apo sqarime për mënyrën dhe vlerën e pagesave të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

16.13 Sa më sipër referuar në këtë vendim, Kolegji vëren se shoqëria e ndërtimit i ka dërguar Komisionit bashkë me informacionin edhe disa foto, të cilat paraqesin pamje nga njësitë e shërbimit të blera nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, në vërtetimin e lëshuar nga shoqëria e ndërtimit në datën 14.06.2021, është sqaruar se njësitë janë dorëzuar në gjendjen karabina. Ky informacion/shkresë është i vitit 2021 dhe nuk ka qartësi në çfarë viti janë marrë këto pamje, por ajo që vihet re është se njësitë janë të përfunduara dhe duket qartë se nuk janë në gjendje karabina. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, pretendoi se ato janë foto që i përkasin vitit 2021, duke pretenduar se Komisioni nuk i vuri në dispozicion dosjen e provave për t'u njohur e mbrojtur, pretendim i cili nuk gjendet i bazuar, pasi ai u njoftua në datën 09.07.2021 për të drejtën e njohjes me dokumentacionin e dosjes së tij të rivlerësimit, të drejtë të cilën nuk e ushtroi (paragrafi 7.1 më sipër).

16.14 Kolegji vëren se deri në këtë datë, nga tërësia e deklaratave dhe kontratave që subjekti ka lidhur me shoqërinë e ndërtimit, rezulton se vetëm në deklaratën noteriale të datës 04.06.2018 është përcaktuar se të tri njësitë objekt shqyrtimi janë dorëzuar në gjendjen karabina për çmimin prej 105.000 eurosh. Është e paqartë se përse më datë 05.11.2019 është nënshkruar deklarata tjetër noteriale (paragrafi 16.9 më sipër) ndërmjet shoqërisë së ndërtimit dhe subjektit të rivlerësimit, tek e cila deklarohet se shuma në total për blerjen e katër ambienteve (4 njërive) është dorëzuar në gjendjen karabina dhe pa rifinitura. Sipas kësaj deklarate, vlera e tyre në total, përfundimisht është në shumën 105.000 euro, shumë e cila është shlyer në total sipas mandateve dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit. Pra, në këtë deklaratë është përcaktuar se çmimi 105.000 euro është paguar për 4 njësitë dhe jo për tre siç është përcaktuar më parë në kontratën e shitjes të vitit 2018, duke përfshirë në këtë çmim edhe njësinë nr. {***}, e cila është blerë në shumën 7.500.000 lekë. Kolegji vlerësoi se deklarata noteriale e datës 05.11.2019, jo vetëm nuk qartëson situatën, por ajo është një akt kontradiktor me kontratën e shitblerjes, e cila ka fuqinë e ligjit. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk ka dorëzuar prova për të provuar mënyrën e pagesës dhe kështu e paguara për likuidimin e këtyre pasurive. Gjurmët e vetme që gjenden nga verifikimi i llogarive bankare janë ato për pagesën e njësisë nr. {***}, për çmimin 7.500.000 lekë në vitin 2015, si dhe pagesa e kryer nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në atë të shoqërisë së ndërtimit në datën 12.01.2018 në shumën 55.000 euro.

16.15 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se gjatë viteve 2016-2017 janë depozituar *cash* nga persona të tretë vlera monetare për shlyerjen e kësteve të kredisë së marrë nga subjekti rivlerësimit dhe

personi i lidhur në OTP Bank, e konkretisht: (i) nga shtetasja M. Ç. janë kryer 15 depozitime, në vlerën totale 2.475.000 lekë; (ii) nga shtetasi F. M. është kryer një depozitim në shtator të vitit 2016, në vlerën 165.000 lekë; (iii) nga shtetasja E. M. është kryer një depozitim në tetor të vitit 2016, në vlerën 165.000 lekë; (iv) nga shtetasi H. M. është kryer një depozitim në janar të vitit 2017, në vlerën 165.000 lekë; dhe (v) nga shtetasi A. Ç. është kryer një depozitim në gusht të vitit 2017, në vlerën 527.000 lekë. Sa më sipër, në kushtet kur fondet e depozituara apo të transferuara nga individët e sipërcituar kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, në referim të pikës 14, të nenit 3 dhe pikës 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vlerësuar se ata bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, duke i kaluar me rezultatet e hetimit barrën e provës për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të depozituara apo të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur. Në konsideratë të faktit që subjekti nuk ka kundërshtuar gjetjet e Komisionit në rezultatet paraprake të hetimit administrativ, si dhe duke qenë se ai nuk ka deklaruar ndër vite në DIPP-së hua apo dhurime që lidhen me këto depozitime apo transferta (sipas parashikimit të bërë në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016), Komisioni, në vendim, konkludoi se në analizën financiare e gjithë vlera e kredisë së shlyer (principal + interes), sipas informacionit të marrë nga “OTP Bank”, të reflektohet si shumë e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe ankimore.

16.16 Në vijim të sa më sipër, Kolegji konsideroi se këto pasuri janë blerë të përfunduara, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi se janë blerë në gjendjen karabina, si dhe çmimi i blerjes së tyre u konsiderua në vlerën prej 246.429 eurosh, sipas parashikimeve të kontratës së prenotimit të lidhur në vitin 2015. Subjekti i rivlerësimit duket se është përpjekur që me disa akte noteriale të hartuara pas kontratës së prenotimit e asaj të shitblerjes të paraqesë një situatë të ndryshme sa i përket gjendjes në të cilën janë dorëzuar këto njësi. Këto akte, përveçse kontradiktore janë të pambështetura në prova të besueshme për të mbështetur versionin e subjektit të rivlerësimit për mos kryerjen e pagesës për vlerën e plotë të kontratës së prenotimit, por edhe të gjendjes në të cilën ato njësi janë dorëzuar. Nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se për këstin e parë të parashikuar në kontratën e prenotimit, si pagesë që është kryer deri në shtator të vitit 2015, sipas specifikimeve të kësaj kontrate, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të paguante këstin e parë për blerjen e pasurisë objekt kontrolli në shumën 50.000 euro. Lidhur me pagesën e kësteve të parashikuara në kontratë për t’u paguar gjatë vitit 2016 në vlerën 100.000 euro (50.000 euro deri në mars të vitit 2016 dhe 50.000 euro deri në nëntor të vitit 2016), rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente pagesat për likuidimin e pasurive për diferencën negative në shumën (-) 3.520.498 lekë. Lidhur me pagesat e mbetura për t’u kryer gjatë vitit 2017 në vlerën 41.429 euro, subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte shpenzimet dhe të kryente pagesën e kështit për likuidimin e pasurive për diferencën negative në shumën (-) 4.751.233 lekë. Në këto kushte, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtyre pasurive, duke u gjendur në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. **Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 109 m², të ndodhur në {***}**, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se nuk është pasuri e tij, por e vëllait. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se vëllai i tij nuk ka qenë në Shqipëri në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes ndërmjet subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Subjekti sqaron se vëllai i tij e ka krijuar këtë pasuri nga puna e kryer gjatë qëndrimit në emigracion, ndaj kundërshton analizën financiare të Komisionit dhe diferencën negative në shumën (-) 7.000.000 lekë si jo profesionale, pasi pretendon se ka paraqitur dokumentacion ligjor për këtë apartament, si dhe për arsyet përse fillimisht për këtë pasuri është lidhur një kontratë paraprake në emër të subjekti të rivlerësimit.

17.1 Konkluzioni i Komisionit, lidhur me këtë pasuri, në vendim, është: *“Në vlerësim tërësor të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe, si rrjedhojë, ai gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. [...] Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë për prenotimin e kësaj pasurie, duke u gjendur edhe në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

17.2 Pasuria objekt kontrolli nuk rezulton se është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting dhe as në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI.

Në raportin²² e ILDKPKI-së, datë 06.09.2018, bazuar në informacionin e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, është evidentuar se në datën 03.02.2011 subjekti i rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë e llojit apartament banimi ndodhur në {***}, për çmimin prej 60.000 eurosh. Komisioni i ka kërkuar informacion ILDKPKI-së për të gjithë dokumentacionin që disponon për subjektin e rivlerësimit përfshirë aktet e kontrollit dhe masat e marra. Në përgjigje, kjo e fundit ka dërguar²³ dokumentacionin e administruar ndër vite në dosjen e subjektit të rivlerësimit. Në përbërje të këtij dokumentacioni, Komisioni ka konstatuar dokumentin me titull “Observacion”, të nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, drejtuar ILDKPKI-së, në të cilin ka parashtruar se ndërmjet bashkëshortit të saj dhe shoqërisë “{***}” ShPK është lidhur një kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.02.2011, e cila është lidhur në kushtet e fiktivitetit, sepse qëllimi i kësaj kontrate ishte prenotimi i një hyrje të ndërtuar nga shoqëria në fjalë, në {***}, për vëllain e tij E. Dh., i cili në atë kohë ndodhej në Greqi. Më tej, shpjegohet se kjo kontratë sipërmarrje nuk është deklaruar për vitin 2011, sepse është një veprim juridik i pavlefshëm i lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë në fjalë.

17.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se me kontratën²⁴ e sipërmarrjes të datës 03.02.2011, subjekti i rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe të përgjithshme 109 m², në objektin që do të ndërtonte kjo shoqëri, në {***}, Lezhë, për çmimin prej 60.000 eurosh. Në këtë kontratë është parashikuar që pagesat do të kryhen me dy këste: (i) kësti i parë në shumën prej 50.000 eurosh është likuiduar paraprakisht; dhe (ii) diferenca e mbetur do të paguhet me përfundimin e objektit.

²² Faqe 29 e raportit të ILDKPKI-së.

²³ Shkresë nr. {***} prot., datë 16.03.2021, e ILDKPKI-së.

²⁴ Kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.02.2011.

Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, mosdeklarimin e saj, si edhe për burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë në shumën prej 50.000 eurosh. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit citoi se *kësaj pyetjeje unë i jam përgjigjur në deklarimin përfundimtar.*

17.4 Më datë 19.10.2013, shoqëria “{***}” ShPK (përfaqësuar nga administratori) dhe subjekti i rivlerësimit kanë nënshkruar deklaratën noteriale²⁵ “Për prishje kontrate”, në të cilën kanë deklaruar se në datën 03.02.2011 kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes për porositjen e ndërtimit të apartamentit me sipërfaqe 109 m², në objektin që shoqëria “{***}” ShPK po ndërton në {***}, Lezhë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ky apartament është porositur nga ai formalisht në mungesë të vëllait të tij, i cili ishte emigrant me dokumente në Greqi dhe në kohën e përpilimit të kontratës nuk kishte mundësi të ishte prezent në nënshkrimin e saj. Gjithashtu, deklaroi se shoqëria “{***}” ShPK, në kohën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, është vënë në dijeni që me të ardhur vëllai i subjektit në Shqipëri ata do të bëjnë revokimin e kontratës së sipërmarrjes datë 03.02.2011 dhe do ta lidhin me vëllain e tij dhe të gjitha të drejtat e fituara nga subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës së mësipërme, do t’i kalojnë vëllait në kontratën e re që palët do nënshkruajnë me njëri-tjetrin. Sipas kontratës nga shoqëria do të njihen të gjitha pagesat e kryera deri në momentin e lidhjes së kontratës së re dhe nuk ndryshon asgjë nga kushtet e kontratës së parë të lidhur me subjektin. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se heq dorë nga çdo e drejtë pronësie dhe pretendim ndaj pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 109 m² e ndodhur në objektin që shoqëria “{***}” ShPK ka ndërtuar në {***}.

Shoqëria ndërtuese deklaroi se heq dorë nga kontrata e parë e sipërmarrjes së sipërcituar dhe gjithë pagesat e saj i kalon për llogari të kontratës që do të nënshkruajnë me z. E. Dh., në të njëjtën ditë të nënshkrimit të kësaj deklarate noteriale.

17.5 Ashtu si u paraqit dhe më sipër, në të njëjtën datë me deklaratën noteriale (19.10.2013), është lidhur kontrata tjetër e sipërmarrjes²⁶ “Për ndërtim apartamenti” ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. E. Dh. (vëllai i subjektit), me objekt porositjen e një apartamenti në godinën e banimit që do të ndërtohet nga sipërmarrësi, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 109 m². Në këtë kontratë është përcaktuar se pagesa për vlerën e apartamentit do të likuidohet nga porositësi për llogari të sipërmarrësit si vijon: (i) kësti i parë prej 50.000 eurosh është likuiduar paraprakisht; (ii) diferenca e mbetur do të paguhet me përfundimin e objektit. Komisioni pyeti sërish subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për rrethana të tjera që lidhen me këtë pasuri, në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit sqaroi se ai personalisht nuk ka bërë asnjë pagesë dhe nuk i është kthyer asnjë pagesë nga vëllai i tij, dhe se sqarimin për këtë çështje e ka bërë tek ILDKPKI-ja në momentin e duhur. Komisioni kreu verifikimin në sistemin *TIMS*, nga i cili rezultoi se z. E. Dh. ka qenë në territorin shqiptar në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK (datë 03.02.2011). Gjithashtu, konstatoi se dalja e parë e këtij shtetasi jashtë territorit shqiptar është në datën 25.05.2011 (kjo sa i takon periudhës për të cilën sistemi *TIMS* disponon të dhëna). Për më tepër, Komisioni evidentoi se në datën 04.03.2011

²⁵ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2013.

²⁶ Kontratë sipërmarrje për ndërtim apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2013.

(një ditë pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes) z. E. Dh. ka depozituar *cash* në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, shumën prej 128.400 lekësh, me përshkrimin “*E. Dh. derdh këst kredie*”.

17.6 Në vijim të sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 porositjen e kësaj pasurie dhe të drejtat reale mbi të, pagesën e kryer gjatë këtij viti (si shpenzim), burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e kryer, si edhe subjektin me të cilin ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale, duke u munduar të fshehtë këtë pasuri dhe interesat privatë që e lidhin me të.

Komisioni vlerësoi se apartamenti në {***} është pasuri e porositur dhe e paguar nga subjekti i rivlerësimit me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tij, por në vijim i ka transferuar të drejtat e kësaj pasurie tek i vëllai, z. E. Dh., në dukje, me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve, të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes. Lidhur me sa më sipër, mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme të ngritura, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjekti i rivlerësimit. Siç është theksuar edhe më lart, subjekti nuk ka depozituar prapësime dhe prova për të kundërshtuar rezultatet e hetimit.

17.7 Në vijim të sa më sipër, Kolegji konstaton se janë lidhur dy kontrata sipërmarrje, e para në vitin 2011, ndërmjet subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit dhe e dyta në vitin 2013, ndërmjet vëllait të subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit. Në kontratën e parë të sipërmarrjes është përcaktuar çmimi i blerjes së apartamentit në shumën 60.000 euro, si dhe mënyra e pagesave, nga e cila është përcaktuar se kësti i parë prej 50.000 eurosh është likuiduar paraprakisht, ndërsa pjesa tjetër kur të përfundojë objekti. Në kontratën e dytë të sipërmarrjes, të lidhur në vitin 2013 nga vëllai i subjektit dhe shoqëria e ndërtimit, janë parashikuar të njëjtat kushte pagese, ku, ndër të tjera, parashikohej se kësti prej 50.000 eurosh është likuiduar paraprakisht, ndërsa pjesa e mbetur do të paguhet në përfundim të objektit.

17.8 Në datën kur është lidhur kontrata e dytë e sipërmarrjes (19.10.2013) është nënshkruar edhe deklarata noteriale ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit.

Pra, nëpërmjet kësaj deklarate noteriale është hequr dorë nga kontrata e parë e sipërmarrjes e vitit 2011, duke pretenduar që t'i kalojnë të drejtat e pronësisë vëllait të subjektit të rivlerësimit. Në shqyrtim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se deklarata noteriale është një akt, i cili nënshkruhet para noterit mbi bazën e deklarimeve të palëve nënshkruese të saj, por nuk krijon, ndryshon dhe shuan marrëdhënie juridike. Pra, revokimi i kontratës së sipërmarrjes së kësaj pasurie nuk është kryer me një akt noterial, për të provuar vullnetin e palëve lidhur me zgjidhjen e kësaj marrëdhënieje të pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2011. Në këtë rast, për revokimin e kontratës së sipërmarrjes dhe shuarjen e efekteve të saj, kërkohet një akt i shkruar “*ad substantiam*”, që përmban të shprehur në mënyrë specifike vullnetin e palëve dhe që i korrespondon vullnetit real. Për më tepër, nga tërësia e rrethanave, nuk gjejmë kthimin mbrapsht të pagesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit, referuar citimit në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2011, ku është parashikuar se kjo shumë është likuiduar paraprakisht.

17.9 Në vijim të sa më sipër, Kolegji vlerëson se një kontratë e lidhur para noterit, e regjistruar në regjistrin noterial kombëtar, nuk mund të revokohet me një deklaratë noteriale, e cila në thelb nuk mund të zhbëjë një kontratë, e cila ka sjellë efekte juridike siç është ai i fitimit të pronësisë. Kjo situatë, lidhur me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe të metat në anën formale të akteve të analizuara, sillet në vëmendje si një element që do të shoqërojë në vijim edhe analizën për verifikimin e burimeve të financimit të këtij apartamenti të kontraktuar në vitin 2011.

Krahas analizës së mësipërme, Kolegji kontrollon analizën financiare të kryer nga Komisioni lidhur me burimet e financimit të subjektit, në vlerën prej 50.000 eurosh të këtij apartamenti në momentin e kryerjes së pagesës, e cila, sipas kontratës së sipërmarrjes, rezulton të jetë deri në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes më datë 03.02.2011. Nga kontrolli i analizës rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi të përballonin shpenzimet dhe të kryerin pagesën e kështit prej 50.000 eurosh për diferencën negative prej (-) 6.977.770 lekësh, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

17.10 Në përmbledhje të sa më sipër, për pasurinë apartament banimi të ndodhur në {***}, trupit gjykues i rezultoi se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj në DIPP-në e vitit 2011, pretendimin për revokim në vitin 2013 dhe as në deklaratën *vetting*.
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi dokumente si fatura, mandatarkëtime apo banke për likuidimin e shumës 50.000 euro, të shënuar në kontratën e sipërmarrjes si të likuiduar paraprakisht, çka mund të përbëjë shkak për të krijuar dyshimin e arsyeshëm se kjo shumë është dhënë *cash* prej tij.
- iii) Kontrata e sipërmarrjes së vitit 2011 është pretenduar se është revokuar me deklaratën noteriale të vitit 2013, për të vijuar në të njëjtën ditë me lidhjen e kontratës tjetër të sipërmarrjes së vitit 2013.
- iv) Nuk rezulton se shuma e likuiduar si kësht i parë sipas kontratës së sipërmarrjes t’i jetë kthyer subjektit të rivlerësimit nga vëllai i tij.
- v) Subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi asnjë dokumentacion për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit.
- vi) Subjekti i rivlerësimit nuk kishte burime financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.

Në konsideratë të rrethanave dhe situatës faktike të mësipërme, Kolegji konkludoi se pasuria apartament banimi me sip. 109 m² e ndodhur në {***}, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

18. **Lidhur me pasurinë “njësi tregtare” me sipërfaqe 124 m²**, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konkluzioni i vendimit të Komisionit se kjo pasuri i atribuohet atij është i gabuar dhe aludues. Subjekti sqaron se ka paraqitur të gjitha provat shkresore që provojnë se ka qenë dorëzanës në kredinë që ka marrë kunati i tij A. Ç.. Subjekti shpjegon se kjo pasuri është regjistruar në emër të kunatit të tij dhe se ky i fundit e posedon dhe mund ta disponojë lirisht atë. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj

pasurie janë të ardhurat e përfituara nga kunati i tij, i cili nuk është akuzuar asnjëherë për ndonjë vepër penale që do t'i sillte përfitime të paligjshme.

18.1 Konkluzioni i Komisionit, për këtë pasuri, në vendim, është: “[...] subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kështit të parë për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, qoftë edhe në përmbushje të detyrimit si garantues i kontratës, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. [...] Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë dhe, si rrjedhojë, ai gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. [...] Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera gjatë viteve 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, vlerësuar si pasuri e fshehur prej tij, duke u gjendur edhe në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016”.

18.2 Rezulton se në DIPP-në e vitit 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kredi tek Raiffeisen Bank si garantues. Vlera: 10.000.000 lekë. Pjesa: 50%”.

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar: “Pagesë kredie tek Raiffeisen Bank, afërsisht paguar 15 milionë lekë të vjetra, principali afërsisht 95 milionë të vjetra”.

Në DIPP-të e viteve 2012 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklarime në lidhje me këtë kredi.

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Gjendja e kredisë në 31 dhjetor 2014, sipas statement të Raiffeisen Bank. Pagesa është bërë nga shtetasi A. Ç. për llogari të të cilit është marrë dhe kredia, gjë e cila është sqaruar dhe në deklaratimet e mëparshme. Pagesa totale e kështit 1.612.603 lekë. Pagesa totale e interesave 669.429 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur është 5.706.207 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Likuiduar nga z. A. Ç. kredia e marrë prej tij, duke çliruar nga dorëzania z. Ken Dhima dhe znj. K. Ç.”.

18.3 Në përgjigjen²⁷ që ILDKPKI-ja i ka dërguar Komisionit ka dërguar edhe dokumentacionin e administruar ndër vite në dosjen e subjektit të rivlerësimit, në përbërje të të cilit gjendet dokumenti me titull “Sqarim” me shënimin me shkrim dore “PV-2012 Ken”, i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, drejtuar ILDKPKI-së, në të cilin kanë sqaruar se: “[...] në vitin 2010 është marrë një kredi në shumën 10.000.000 lekë nga ne si dorëzanës të shtetasit A. Ç.. Kjo për të paguar një ambient dyqan sipas kontratës së sipërmarrjes ndërmjet tij dhe shoqërisë {***}. Duam t’ju theksojmë se kjo kredi është marrë në emrin tonë për faktin se vetë subjekti A. Ç. (përkatesisht kunati dhe vëllai) nuk mund të merrte kredi sepse nuk plotësonte kushtet. Të gjitha pagesat e kësteve bëhen rregullisht nga ana e shtetasit A. Ç., në disa raste kur shtetasi A. Ç. ka vonuar një apo dy ditë pagesën, ajo është mbajtur nga llogaria e K. Ç., e cila është rikthyer menjëherë nga A. Ç.. Gjithashtu, në 2 prill 2012 është bërë një parapagesë e një pjese të principalit

²⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë 16.03.2021, e ILDKPKI-së.

të kredisë nga A. Ç. në shumën 2.400.000 lekë. Po e bëjmë këtë sqarim sepse nuk e kemi pasqyruar në deklarin e pasurisë për shkak të formatit të saj [...]”.

18.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se me kontratën e porosisë (jo noteriale) së datës 05.08.2009, z. A. Ç. në cilësinë e porositësit dhe subjekti i rivlerësimit në cilësinë e garantuesit kanë porositur nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë e llojit dyqan me sipërfaqe 124 m², në objektin që kjo shoqëri po ndërtonte në rrugën “{***}”, Tiranë, për çmimin prej 220.000 eurosh. Në këtë kontratë, është përcaktuar plani i pagesave si vijon: (i) kësti parë në shumën 30.000 euro, më datë 05.08.2009; (ii) kësti i dytë në shumën 50.000 euro më datë 25.10.2009; (iii) kësti i tretë në shumën 70.000 euro më datë 25.03.2010; (iv) kësti i katërt në shumën 50.000 euro më datë 25.10.2010; dhe (v) kësti i pestë në shumën prej 20.000 eurosh, kur porositësit t’i jepet certifikata e pronësisë. Gjithashtu, në dosje gjendet i administruar edhe një mandatarëkëtim me nr. {***}, datë 05.08.2009, sipas së cilit janë likuiduar për shoqërinë e ndërtimit 30.000 euro, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

18.5 Me kontratën tjetër të porosisë (jo noteriale) të datës 10.08.2009 (5 ditë nga kontrata e porosisë e cituar në parag. më sipër), z. A. Ç. ka porositur nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë e llojit dyqan me sipërfaqe 124 m², në objektin që kjo shoqëri po ndërtonte në rrugën “{***}”, Tiranë, për çmimin prej 150.000 eurosh. Në këtë kontratë, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar në cilësinë e garantuesit. Ndërsa plani i pagesa përcaktohet si vijon: (i) kësti parë në shumën 30.000 euro në datën 05.08.2009; (ii) kësti i dytë në shumën 30.000 euro në datën 25.10.2009; (iii) kësti i tretë në shumën 30.000 euro në datën 25.03.2010; (iv) kësti i katërt në shumën 50.000 euro në datën 25.10.2010; si dhe (v) kësti i pestë në shumën 10.000 euro, kur porositësit t’i jepet certifikata e pronësisë.

Sa më sipër, rezultojnë dy kontrata porosie për të njëjtin objekt (dyqanin prej 124 m²), me të njëjtat palë, të nënshkruara në dy data të ndryshme, në të cilat ndryshon çmimi dhe kështu e pagesave. Në të dy këto kontrata është parashikuar se në rast se porositësi, z. A. Ç., nuk respekton detyrimet e shkruara në këtë kontratë, atëherë të gjitha ato kalojnë në mënyrë automatike tek garantuesi i kësaj kontrate, z. Ken Dhima, i cili merr përsipër pa asnjë imponim dhe me vetëdije të plotë të gjitha detyrimet ekonomike dhe sanksionet e cituara në kontratë (neni 13 i kontratës).

18.6 Komisioni ka konstatuar se shoqëria “{***}” ShPK përfaqësuar nga administratori, z. P. K., me shkresën nr. {***} prot., datë 03.01.2012, drejtuar ILDKPKI-së²⁸, informon se nuk kanë marrëveshje kontraktuale me subjektin K. Sh. Dh. (Ç.) dhe z. Ken Dhima. Marrëveshja kontraktuale që ata kanë është kontrata e porosisë e datës 10.08.2009 me z. A. Ç., kunatin e z. Ken Dhima, për blerjen e një dyqani, me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 124 m², për vlerën prej 150.000 eurosh. Në këtë kontratë, z. Ken Dhima, për shkak të njohjeve personale të mëparshme (përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, z. P.K.), është quajtur “garantues i kontratës”. Kjo zgjidhje u bë prej administratorit për shkak të pasigurisë që paraqiti z. A. Ç. në likuidimin e kësteve të parashikuara në kontratë. Në vijim të likuidimit të detyrimeve z. Ar. Ç. ka paguar në rrugë bankare shumat: (i) 2.000.000 lekë në datën 30.10.2009; (ii) 5.000 euro në datën

²⁸ Protokolluar në ILDKPKI me nr. {***} prot., datë 05.01.2012.

07.01.2010; si dhe (iii) 1.000.000 lekë në datën 05.05.2010. Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me pagesat e pretenduara si të kryera nga A. Ç., në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, përfshirë edhe pagesat e referuara në informacionin e dërguar në ILDKPKI nga shoqëria “{***}” ShPK, si të kryera në rrugë bankare.

18.7 Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij, në cilësinë e bashkë kredimarrësve kanë marrë kredi²⁹ konsumatore në shumën 10.500.000 lekë, në datën 02.10.2010, në Raiffeisen Bank, për një afat 15-vjeçar. Në këtë kontratë, individët P. dhe M. K., të cilësuar si hipotekues, kanë lënë si kolateral pasurinë në pronësi të tyre, e llojit apartament me sipërfaqe 134 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Më pas, ky kolateral është ndërruar dhe është vendosur pasuria e llojit “njësi” me sipërfaqe 124 m², e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, që është pasuria objekt kontrolli. Në datën 08.10.2010 është disbursuar në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit, znj. K. Ç., shuma prej 10.500.000 lekësh, ndërsa në datën 11.10.2010, nga kjo llogari, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka transferuar shumën prej 7.800.000 lekësh në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin “pagesë detyrimi”. Shuma prej 2.000.000 lekësh është tërhequr *cash*, ndërsa pjesa tjetër ka shërbyer për pagesa komisionesh, vlerësimesh dhe siguracion kredie. Kjo kredi është shlyer deri në datën 15.05.2015, para afatit të përcaktuar në kontratën e kredisë. Pagesat e kryera për shlyerjen e kësaj kredie janë paguar nga të ardhurat e kredituara në llogari dhe shuma në total, përfshirë principal, interes dhe sigurime jete dhe prone, është në vlerën prej 15.128.979 lekësh. Gjithashtu, rezultoi se në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit janë kryer pagesa nga persona të ndryshëm në vlera të ndryshme monetare, përkatësisht nga shtetasit E. Dh., B. S., F. E., A. Ç. dhe H. B.. Nga verifikimi bankar rezulton se z. A. Ç. ka depozituar/transferuar në këtë llogari shumën prej 10.968.640 lekësh. Subjekti është pyetur nga Komisioni në rezultatet paraprake të hetimit administrativ për pagesat e kryera nga këta persona dhe për marrëdhënien që ai dhe bashkëshortja kanë me ta, por subjekti nuk ka dërguar shpjegime në lidhje me sa më sipër. Në mungesë të shpjegimeve në lidhje me pagesat e kësteve të kredisë nga persona të tjerë, në analizën financiare të kryer në Komision, shpenzimet për pagesën e këtyre kësteve janë përllogaritur si të paguara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, qëndrim ky i cili u gjet i drejtë edhe nga kontrolli i ushtruar në Kolegj.

18.8 Në dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPKI-së gjendet një deklaratë pasurie e z. A. Ç., kunati i subjektit të rivlerësimit, me profesion avokat, i cili ka kryer deklaram me kërkesë në datën 25.03.2013, në të cilën deklaron pasurinë e tij dhe, ndër të tjera, deklaron se ka në pronësi një dyqan me sipërfaqe 130 m² të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, me pjesë takuese 100%. Në dosjen e ILDKPKI-së gjendet i administruar vendimi nr. {***}, datë 07.02.2013, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, për vendosjen e gjobës për mosdeklarim të interesave private me kërkesë, sipas nenit 7³⁰ të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Në këtë

²⁹ Kontratë kredie bankare dhe hipoteke me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.10.2010.

³⁰ Neni 7 i ligjit nr. 9049/2003 parashikon: “Inspektori i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë deklarimin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të urdhërojë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarameve edhe për personat fizikë e juridikë, kur, nga verifikimet e kryera, rezulton se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim”.

vendimmarrje evidentohet se z. A. Ç. i është kërkuar nga ILDKPKI-ja të plotësojë formularin “Deklaratë e interesave private me kërkesë”, ku duhet të pasqyrohet pasuritë e tij, interesat private dhe burimet e krijimit të tyre. Z. A. Ç., edhe pse ka marrë dënim dhe është njohur me detyrimet ligjore për plotësimin e saj dhe pasojat në rast refuzimi, nuk ka dorëzuar në afat deklaratën e interesave private me kërkesë. Për këtë arsye, me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2013, të ILDKPKI-së, z. A. Ç., si person i lidhur që mbart detyrimin për deklarim, është dënuar me gjobë në shumën 50.000 lekë.

18.9 Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të, për pagesat e viteve 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit prej 220.000 eurosh në referim të parashikimeve të kontratës së porosisë së datës 05.08.2010, sipas së cilës: (i) për vitin 2009 është paguar shuma prej 80.000 eurosh; dhe (ii) për vitin 2010 është paguar shuma prej 120.000 eurosh. Nga kjo analizë rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mund të përballonin me burime financiare të ligjshme kryerjen e pagesave për pasurinë objekt kontrolli, për diferencat negative në shumën (-) 11.498.687 lekë në vitin 2009 dhe (-) 6.245.124 lekë në vitin 2010.

18.10 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se ka gjurmë dokumentare vetëm për dy pagesa të kryera nga subjekti dhe bashkëshortja e tij për këtë pasuri si: (i) mandati prej 30.000 eurosh, paguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 05.08.2009; dhe (ii) pagesa e kryer në datën 11.10.2010 në shumën prej 7.800.000 lekësh, nga llogaria e personit të lidhur në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, me burim fondet e përfituara nga kredia bankare në Raiffeisen Bank. Vetë shoqëria e ndërtimit, në informacionin e dërguar ILDKPKI-së (paragrafi 18.6 më sipër), ka sqaruar se marrëveshja kontraktuale që ata kanë është kontrata e dytë e porosisë së datës 10.08.2009 me z. A. Ç., kunatin e subjektit të rivlerësimit, për blerjen e një dyqani, me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë. Shoqëria e ndërtimit nuk ka dorëzuar në Komision dokumentacion për mënyrën e pagesave dhe as sqarime në lidhje me pagesat e kryera, përveç mandatpagesës së shumës 30.000 euro të kryer më datë 05.08.2009.

18.11 Në kontratën e kredisë së marrë nga Raiffeisen Bank, është parashikuar se qëllimi i dhënies së saj është “konsumatore me hipotekë”, pa parashikuar qëllimin në mënyrë të qartë për marrjen e saj. Konstatohet se menjëherë pas disbursimit të kredisë bashkëshortja e subjektit ka kaluar shumën prej 7.800.000 lekësh në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit. Në praktikën e kësaj kredie, rezulton se ortakut i vetëm i shoqërisë së ndërtimit ka vendosur kolateral një apartament në pronësi të tij, duke nënshkruar edhe si hipotekues (referuar me këtë cilësi në kontratën e kredisë bankare) bashkë me bashkëshorten e tij në kontratën e kredisë në Raiffeisen Bank, për shkak të njohjeve me subjektin e rivlerësimit.

18.12 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se UKT-ja informon³¹ Komisionin se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron kontratë furnizimi aktive me nr. {***}, me datë hapje 06.04.2011, me detyrime të likuiduara deri në qershor 2019, në adresën rruga “{***}”, Pallati “{***}” ShPK, Tiranë, e cila duket se përkon me adresën e pasurisë objekt vlerësimi. Pasi

³¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 03.04.2020.

Komisioni kërkoi³² dokumentacionin mbi bazën e të cilit është lidhur kjo kontratë furnizimi me ujë të pijshëm, UKT-ja informon³³ se për kontratën nr. {***} (sipër referuar) disponojnë vetëm libër faturimi të vitit 2010. Gjithashtu, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FShU) ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk rezultojnë të jenë abonentë dhe të kenë kontratë të furnizimit të energjisë elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

18.13 Si rrjedhojë e sa më sipër, duke vlerësuar se për shlyerjen e njësisë tregtare rezultuan dy pagesa të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në shumën prej 30.000 eurosh dhe 7.800.000 lekësh, Kolegji vlerësoi që verifikimi i mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për mbulimin me burime financiare të ligjshme të pagesave për çmimin e kësaj pasurie, të bëhet në përputhje me përcaktimet e kontratës së porosisë së datës 05.08.2009, sa i përket shumave dhe momenteve të pagimit të tyre. Nga kontrolli që Kolegji ushtroi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezultoi se në lidhje me pagesat e kësaj të parë dhe të dytë të kryera gjatë vitit 2009 në vlerën prej 80.000 eurosh subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi që me burime financiare të ligjshme të kryenin pagesat dhe të përballonin shpenzimet për diferencën negative në shumën prej (-) 11.063.111 lekësh³⁴. Lidhur me pagesat e kësaj të tretë dhe të katërt të kryera gjatë vitit 2010 në vlerën prej 120.000 eurosh, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi që me burime financiare të ligjshme të kryente pagesat e kësteve dhe të përballonte shpenzimet për diferencën negative në shumën prej (-) 6.245.124 lekësh. Për rrjedhojë, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.14 Në përmbledhje të sa më sipër, për pasurinë “njësi tregtare”, me sipërfaqe 124 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, rezultoi se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj në DIPP-në e vitit 2009 në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë dhe as në deklaratën *vetting*.
- ii) Janë nënshkruar dy kontrata porosie me të njëjtat palë e subjektin e rivlerësimit në cilësinë e garantuesit të kontratës, për të njëjtin shkak, por me ndryshime vetëm tek çmimi dhe plani i pagesave. Kontrata e parë parashikon çmimin e shitjes 220.000 euro, ndërsa e dyta (e lidhur pesë ditë më vonë) parashikon çmimin prej 150.000 eurosh, pjesë e të cilave është subjekti i rivlerësimit, si garantues i përmbushjes së pagesave për blerjen e pasurisë.
- iii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë marrë një kredi në vitin 2010 në Raiffeisen Bank, në shumën 10.500.000 lekë, nëpërmjet të cilës kanë shlyer tek shoqëria e ndërtimit vlerën 7.800.000 lekë.
- iv) Subjekti i rivlerësimit me mandatarë të datës 05.08.2009 ka paguar shumën prej 30.000 eurosh, si kështu i parë për porositjen e njësisë tregtare me sip. 124 m².
- v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 qëllimin e marrjes së kësaj kredie dhe destinacionin e vlerave monetare të përfituara prej saj.

³² Shkresë nr. {***} prot., datë 31.05.2021.

³³ Shkresë nr. {***} prot., datë 18.6.2021.

³⁴ Diferencë e cila ka rezultuar më e ulët se ajo e konstatuar nga Komisioni, për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit. Në Kolegj u përdor kursi i këmbimit sipas publikimeve të Bankës së Shqipërisë në periudhën përkatëse. https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

vi) Për kredinë e marrë pranë Raiffeisen Bank, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, z. P. K., duke qenë administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, i cili ishte nënshkruar në kontratën e porosisë për njësinë tregtare me subjektin e rivlerësimit, ka qenë si kolateral apartamentin në pronësi të tij dhe bashkëshortes, për marrjen e kredisë nga subjekti i rivlerësimit për shlyerjen e njësisë tregtare objekti i kontratës së porosisë.

vii) Refuzimi i Z. A. Ç., pas kërkesës së Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së për deklarimin e pasurive të tij, si dhe të burimit të krijimit, përbën rrethanë, e cila krijon bindjen se nuk ka dashur të tregojë burimin e saktë të krijimit të kësaj pasurie.

viii) Në emër të subjektit të rivlerësimit rezultoi një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm të hapur në vitin 2011 në adresën rruga “{***}”, Pallati “{***}” ShPK, Tiranë.

ix) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

Në konsideratë të rrethanave e fakteve sipërcituar, Kolegji vlerësoi se pasuria “njësi tregtare”, me sip. 124 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë ai gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

19. ***Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe prej 51,65 m²***, ndodhur në qytetin Memaliaj, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se është përfituar nëpërmjet ligjit të privatizimit, rreth 10 vjet para se të bëhej gjyqtar dhe nuk ka pasur për qëllim ta fshehtë atë. Komisioni, në paragrafin 48.2 të vendimit, ka konkluduar se subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie të përfituar nëpërmjet ligjit të privatizimit dhe ka vlerësuar se nuk ka dyshime për pjesën takuese që ai zotëron mbi të. Për rrjedhojë, Kolegji vlerësoi të mos ia nënshtrojë shqyrtimit në Kolegj shkaqet e ankimit që subjekti i rivlerësimit ka ngritur për këtë pasuri.

20. ***Lidhur me pasurinë automjet, tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}***, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se për shkak të një pakujdesie ka deklaruar se ky automjet është dhuruar nga shtetasi R. H., i cili ka qenë përfaqësues me prokurë për automjetin që i është dhuruar subjektit nga z. A. P..

Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se gjendet në konflikt interesi me z. R. H., për shkak të një vendimi gjyqësor të dhënë për të. Subjekti pretendon se Komisioni nuk citon në vendim se si ka vendosur subjekti për këtë çështje dhe se bazuar në legjislacionin për konfliktin e interesit, ky dhurim duhet të ndodhte gjatë gjykimit ose menjëherë pas tij dhe jo tre vite pas dhënies së vendimit. Subjekti i rivlerësimit sqaron se ligji nuk e pengon të ketë marrëdhënie miqësore vite pas gjykrimeve penale apo administrative të një personi, pasi do e privonte të kishte marrëdhënie shoqërore me ¼ e shqiptarëve. Subjekti shpjegon se në dijeninë e tij, z. R. H. ka qenë tregtar makinash i licencuar.

20.1 Konkluzioni i Komisionit, për këtë pasuri, në vendim, është: “*Trupi gjykues vlerëson se në këtë rast subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për cenimin e besimit të publikut, në kuptim të pikës 5 të nenit 61 të këtij ligji*”.

20.2 Në DIPP-në e vitit 2011, në rubrikën “ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Benz 220, vit prodhimi 2002, dhuratë nga shtetasi R. H.”.

Në DIPP-në e vitit 2013, ka deklaruar: “Të ardhura nga shitja e autoveturës, tip Benz, në shumën 4.500 euro”.

20.3 Kolegji konstaton se në pyetësin standard të Komisionit, lidhur me pyetjen nëse subjekti ka pasur dhurime mbi vlerën 500.000 lekë, subjekti është përgjigjur: “Dhuratë makine nga shtetasi R. H. (miku im i ngushtë) tip Benz 220, viti 2011. Shtetasi R. H. ka pasur si biznes shitblerjen e makinave në Shkodër. Qëllimi i dhurimit ka qenë vetëm marrëdhënia miqësore mes nesh dhe për të bërë të mundur lëvizjen time sa më lirisht”.

Komisioni pyeti sërish subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësit nr. 2 lidhur me këtë automjet, e konkretisht për marrëdhënien me dhuruesin:

- i) nëse ka gjykuar çështje gjyqësore civile/penale, me palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar këtë shtetas;
- ii) për burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga dhuruesi; si dhe
- iii) nëse ka paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara në momentin e shitjes së kësaj pasurie në vitin 2013.

Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk është në dijeni se kur e ka fituar pronësinë pala dhuruese, dhe pasi kanë kaluar shumë vite e ka të vështirë ta gjejë për shkak të humbjes së kontaktit me këtë shtetas. Gjatë kohës që punonte si gjyqtar në Shkodër ka krijuar marrëdhënie miqësie me të dhe nuk mban mend që të ketë gjykuar ndonjë çështje që ka lidhje me të apo familjarë të tij. Në kohën që ata ishin miq, ai ushtronte si aktivitet tregtinë e makinave, por nuk kishte dijeni nëse licencën e kishte në emër të tij apo të ndonjë familjari. Lidhur me shitjen e automjetit në shumën 4.500 euro, nuk mban mend në janë shlyer detyrimet tatimore.

20.4 Nga dokumentacioni i dosjes rezulton se në fashikullin e DPSHTRr-së gjendet e administruar kontrata³⁵ e dhurimit të automjetit, datë 30.09.2011, sipas së cilës z. A. P., përfaqësuar me prokurë të posaçme nga z. R. H., i dhuron subjektit të rivlerësimit automjetin objekt kontrolli. Pavarësisht kësaj kontrate, rezulton se subjekti i rivlerësimit në të gjitha deklaratimet e tij, përfshirë dhe pyetësorët, ka identifikuar si dhurues të këtij automjeti z. R. H.. Sipas aktit “Dokument Hyrje Leje Qarkullimi Provizore”, me nr. {***} prot., datë 29.09.2011, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Shkodër, rezulton se në datën 27.09.2011 ky mjet ka hyrë në territorin, shqiptar, nëpërmjet pikës kufitare të Muriqanit dhe si pronar i këtij mjeti identifikohet shtetasi R. H.. Referuar deklaratës doganore në datën 28.09.2011 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij mjeti, duke vlerësuar si bazë të taksueshme shumën 655.800 lekë, ndërsa detyrimet doganore në shumën 131.160 lekë. Në certifikatën italiane të pronësisë, me nr. {***}, figuron si pronar i mjetit z. A. P..

20.5 Sa më sipër, bazuar në pikën 14, të nenit 3 dhe pikën 4, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arsyetoi se z. R. H., si dhurues i automjetit të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në

³⁵ Kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.09.2011.

rrethin e personave të tjerë të lidhur e, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti dhe pagesat e kryera për zhdoganimit e tij. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. R. H., të cilat pretendohen se kanë mundësuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. Si rrjedhojë, Komisioni konkludoi se personi tjetër i lidhur, z. R. H., nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar blerjen e këtij automjeti, të cilin ia ka dhuruar subjektit të rivlerësimit.

20.6 Komisioni, përveç sa më sipër, kërkoi informacion³⁶ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nëse subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje civile apo penale për z. R. H., e cila në përgjigje informon³⁷ se z. Ken Dhima ka gjykuar çështjen penale me të pandehur shtetasin R. Y. H. (dhuruesi i pasurisë objekt vlerësimi). Bashkëngjitur shkresës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dërguar vendimin nr. {***}, datë 27.03.2008, sipas së cilit rezulton se subjekti i rivlerësimit Ken Dhima, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka gjykuar çështjen me të pandehur shtetasin R. H., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Komisioni konkludoi se në marrëdhënien e sipërcituar subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, si dhe është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve”, i ndryshuar.

20.7 Në vlerësim të rrethanave si më sipër, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 dhurimin e automjetit nga z. R. H.. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se në kontratën e dhurimit, datë 30.09.2011, dhuruesi (R. H.), i referuar nga subjekti i rivlerësimit, ka cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të z. A. P., i cili, sipas kontratës së dhurimit, ka cilësinë e dhuruesit të automjetit objekt kontrolli, pasi figuron të jetë edhe pronari i tij, sipas dokumentacionit italian të automjetit, regjistruar në emër të tij (A. P.) në Regjistrin Publik Automobilistik më datë 06.09.2010, në Provincën e {***}, Itali. Ky automjet, sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e DPSHTRr-së (paragrafi 20.4 më sipër), ka hyrë në Shqipëri më datë 27.09.2011. Të nesërmen mjeti është zhdoganuar, sipas deklaratës doganore dhe në datën 30.09.2011 është hartuar akti i dhurimit i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe dhuruesi A. P., i përfaqësuar me prokurë nga z. R. H.. Pavarësisht dokumentacionit të administruar në dosje, ku pronar i mjetit në Itali dhe Shqipëri figuron z. A. P., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si dhurues të mjetit z. R.H.. Megjithëse iu kërkua nga Komisioni të vërtetonte që ky i fundit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, të provonte të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e mjetit, subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi dokumentacion ligjor për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

20.8 Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se subjekti i rivlerësimit tre vite përpara se t’i dhurohej automjeti nga z. R. H. ka gjykuar çështjen me të pandehur këtë të fundit, për të cilin, sipas vendimit të cituar në paragrafin 20.6 më sipër, është deklaruar fajtor dhe është dënuar me gjobë në masën 105.000 lekë. Nga verifikimi i të dhënave të këtij vendimi, Kolegji

³⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 27.05.2021.

³⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë 01.06.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

konstaton se z. R. H. është akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290, paragrafi 1³⁸ i Kodit Penal. Nga rrethanat e përshkruara në tekstin e vendimit rezulton se më datë 29.12.2007, në aksin rrugor Shkodër-Krye Bushat, mjeti që drejtohej nga shtetasi R. H. është përplasur me një mjet tjetër, ku nga përplasje janë plagosur lehtë tre persona. Në gjykim është administruar akti i ekspertimit autoteknik, nga i cili është dhënë konkluzioni se përplasje e mjeteve ka ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit nga i pandehuri R. H.. Ky i fundit ka pranuar akuzën, si dhe ka kërkuar gjykim të shkurtuar. Prokurorja e çështjes ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit dhe dënimit e tij me gjobë në shumën 150.000 lekë. Në vendim është arsyetuar se gjykata duhet të mbajë parasysh faktin që në rastin konkret kanë ardhur pasojat më të lehta që parashikon dispozita, si dhe fakti që i pandehuri është i padënuar më parë, rrethana këto që duhet të mbahen parasysh në kërkimet për llojin dhe masën e dënimit. Gjykata, gjithashtu, ka mbajtur parasysh faktin që çështja u gjykua me procedurë të shkurtuar, si dhe merr parasysh rrezikshmërinë e autorit dhe të veprës penale. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit R. Y. H. për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290, paragrafi 1 i Kodit Penal dhe dënimit e tij me 150.000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri dënohet me 100.000 lekë gjobë me afat shlyerje 1 vit [...]”*.

Tre vite pas dhënies së këtij vendimi, subjektit të rivlerësimit i është dhuruar nga R. H. (i pandehuri) automjeti tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2002, për të cilin Komisioni ka konkluduar se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

20.9 Në vlerësim të sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfituar një automjet dhuratë nga z. R. H., i cili *de jure* ka qenë përfaqësues me prokurë, që ka nënshkruar kontratën e dhurimit, duke përfaqësuar dhuruesin z. A. P.. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 si dhurues z. R. H., për të cilin, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, nuk provoi me dokumentacion justifikues se kishte të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të dhuruar automjetin. Gjithashtu, rezultoi se subjekti ka gjykuar çështjen me të pandehur z. R. H. tre vite përpara dhurimit të automjetit. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 , të Komisionit, kur u pyet për marrëdhënien me dhuruesin, ka deklaruar se R. H. është një mik i ngushtë i tij. Në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike*. Në germën “a” të pikës 4 të nenit të mësipërm parashikohet se: *“Konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij zyrtare*. Ndërsa neni 17, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale parashikon: *“Gjyqtari ka detyrë të heqë*

³⁸ Neni 290, paragrafi 1 i Kodit Penal, para ndryshimeve të pësuar me ligjin nr. 144/2013 ka parashikuar: *“Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet”*.

dorë nga gjykimi i çështjes konkrete kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie". Kolegji vëren se, nëse situata faktike do të kualifikohej sipas dispozitave më sipër në këtë paragraf, Komisioni mund ta mbante parasysh këtë fakt në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, kriter, i cili nuk është shqyrtuar nga Komisioni për çështjen e rivlerësimit që i përket z. Ken Dhima.

21. Lidhur me disa deklaratime të tjera të subjektit të rivlerësimit, që kanë rezultuar në Komision nga verifikimi i deklaratave të interesave private/periodike vjetore të depozituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe i deklaratës *vetting*, që kanë të bëjnë me dhurime, hua, sponsorizime/ndihma financiare, shpërblime etj., subjekti i rivlerësimit sqaron se ka bërë vetë deklaratime disa herë para ILDKPKI-së, ashtu edhe para oficerëve të policisë gjyqësore të Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Sipas subjektit, të gjitha këto sponsorizime janë konfirmuar edhe me akt noterial dhe burimet financiare të personave tjerë të lidhur kanë qenë të ligjshëm. Subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit janë vetëm hamendësime dhe të pavërteta, duke sqaruar se nëse nuk do t'i deklaronte ato do të kryente fshehje apo mosdeklarim pasurie. Subjekti kundërshton vendimin e Komisionit, pasi, sipas tij, mbështetet në një hetim joprofesional dhe bazohet vetëm në konkluzione të nxjerra nga ILDKPKI-ja.

21.1 Konkluzionet e Komisionit, lidhur me këto dhurime, sponsorizime e shpërblime, në vendim, janë: *"Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti prapësimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, sipas parashikimit të bërë në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se këto vlera monetare të deklaruara si dhurime, hua, shpërblime, sponsorizime apo ndihma financiare, të mos reflektohen në analizën financiare dhe si rrjedhojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve"*.

Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe i deklaratës *vetting*, Komisioni evidentoi deklaratime të bëra për hua, dhurime, sponsorizime, ndihma financiare, si edhe të ardhura nga shitja e librave të pasqyruara si në vijim.

21.2 *Dhuratë në shumën prej 400.000 lekësh nga Sh. dhe M. Ç.*

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga dhurimi i bërë në vitin 2007 (për mobilim shtëpie), nga Sh. e M. Ç. në vlerën 400.000 lekë, që provohet me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2012.

Gjithashtu, rezulton se në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar dhuratë në të holla nga vjehri dhe vjehrra, në shumën 400.000 lekë.

Referuar deklaratës noteriale³⁹ të datës 19.10.2012, prindërit e bashkëshortes së subjektit, Sh. dhe M. Ç., deklarojnë se i kanë dhuruar vajzës së tyre K. Ç. në vitin 2007, një shumë prej 400.000 lekësh, për mobilimin e shtëpisë së saj të re.

21.3 *Hua në shumën 10.000 euro nga z. E. Z.*

³⁹ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.10.2012.

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si detyrim financiar shumë prej 3.000 eurosh, e cila rrjedh nga huaja e marrë shtetasit E. Z.. Detyrimi i krijuar në vitin 2012 është pa afat dhe pa interes dhe jo i lëvruar nëpërmjet sistemit bankar. Qëllimi i huas ka qenë likuidimi i parakohshëm i një pjese të kredisë të marrë nga Tirana Bank.

Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar detyrim financiar në shumë prej 10.000 eurosh nga kontrata e huasë me shtetasin E. Z., datë 10.01.2012, dhe se kanë shlyer në datën 20.12.2012 (brenda vitit të marrjes) shumë prej 7.000 eurosh, me burim kursimet. Detyrimi i mbetur shuma 3.000 euro.

Referuar deklaratës së datës 10.01.2012 (shkresë e thjeshtë), subjekti i rivlerësimit deklaroi se i ka marrë hua z. E. Z. shumë prej 10.000 eurosh, pa interes dhe pa afat të caktuar shlyerjeje. Ndërsa me deklaratën e datës 20.12.2012 (shkresë e thjeshtë), subjekti deklaroi se i ka shlyer në datën e deklarimit huadhënësit E. Z., shumë prej 7.000 eurosh, dhe se pjesa tjetër e detyrimit do të shlyhet në një afat të pacaktuar. Të dyja deklaratat duket se janë nënshkruar edhe prej huadhënësit, z. E. Z..

Gjithashtu, me anë të deklaratës noteriale⁴⁰ të datës 29.10.2016, z. E. Z. deklaroi se në datën 10.01.2012 i ka dhënë hua pa interes shtetasit Ken Dhima shumë prej 10.000 eurosh. Nga kjo shumë brenda vitit i është likuiduar nga subjekti i rivlerësimit shuma prej 7.000 eurosh.

21.4 Hua në shumë 6.000 euro, nga z. V. Dh.

Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar detyrim financiar në shumë prej 6.000 eurosh, hua e marrë prej babait të tij në fillim të muajit janar të vitit 2012. Huaja është pa afat dhe pa interes. Qëllimi i huasë ka qenë likuidimi i parakohshëm i një pjese të kredisë së mbetur pa shlyer nga Tirana Bank. Rezulton se kjo hua (borxh) është deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 nga subjekti i rivlerësimit, si hua nga babai i tij.

Referuar deklaratës noteriale⁴¹ të datës 18.01.2017, z. V. Dh. ka deklaruar se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit në vitin 2012 hua pa interes, shumë prej 6.000 eurosh, për një afat të pacaktuar kohor.

21.5 Sponsorizime, shpërblime dhe dhurime nga z. A. M., në shumë 64.300 euro

Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Sponsorizim nga shtetasi A. M. për vitet 2008 - 2013. Këto sponsorizime dhe dhurata janë bërë nga ish-presidenti i kompanisë “{***}” ShPK dhe janë dhënë kryesisht për punën time si pedagog pranë universitetit “{***}” për shumë vjet, për kurimin e bashkëshortes K. Ç. jashtë shtetit, si dhe për pushime jashtë vendit së bashku me familjen e tij. Këto pagesa nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar apo nga arka e shoqërisë. Kjo provohet nga vetë shtetasi, si dhe nga dy deklaratat noteriale, të cilat konfirmojnë faktet e parashikuara më sipër*”.

Ndërsa nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstatoi:

⁴⁰ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2016.

⁴¹ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.01.2017.

Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: (i) sponsorizim për pushime në Turqi dhe Egjipt nga A. M. (mik i familjes), shumën prej 3.800 eurosh; (ii) sponsorizim për botim libri nga z. A. M., president i kompanisë “{***}”, shumën prej 20.000 eurosh.

Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: (i) sponsorizim për udhëtim turistik nga z. A. M. (mik i familjes), shumën prej 2.500 eurosh; (ii) sponsorizim nga z. A. M. (mik i familjes), për operacionin e kryer jashtë shtetit, shumën 8.000 euro.

Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar, dhuratë nga z. A. M. (mik i familjes), shumën 10.000 euro.

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar, dhuratë në të holla nga z. A. M., shumën 15.000 euro.

Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shpërblim nga puna si pedagog në Universitetin “{***}”, shumën 5.000 euro.

21.5.1 Referuar dokumentit⁴² me titull “Kontratë dhurimi”, datë 15.01.2008, shtetasi A. M., presidenti i Universitetit “{***}”, ka deklaruar se i dhuron pedagogut të këtij universiteti, z. Ken Dhima, shumën prej 20.000 euro.

Me anë të deklaratës noteriale⁴³ të datës 25.10.2016, shtetasi A. M. ka deklaruar se nga të ardhurat e fituara si rezultat i veprimtarisë tregtare të Universitetit “{***}”, në datën 15.01.2008 i ka dhënë në formë shpërblimi/sponsorizimi shumën prej 20.000 euro, ka sponsorizuar për kurimin e bashkëshortes në Austri dhe, gjithashtu, shpenzimet e udhëtimeve familjare në vitin 2008 në shumën 3.800 euro, për udhëtimin në Turqi.

Me anë të deklaratës noteriale⁴⁴ të datës 22.01.2017, shtetasi A. M. ka deklaruar se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit dhurime për shpërblime dhe sponsorizime për periudhën 2010 - 2013 në shumat 10.000 euro, 15.000 euro dhe 5.000 euro, të cilat nuk janë paguar nga arka e shoqërisë, por nga të ardhurat e tij personale.

Referuar deklaratës⁴⁵ së datës 30.04.2014, z. A. M. ka konfirmuar (pa specifikime në shifra) se ka sponsorizuar tre udhëtime në Turqi dhe për përgatitjen e librave të ndryshëm dhe se nuk i ka përballuar këto shpenzime nga llogaria e shoqërisë, por nga shpenzimet e veta.

21.6 Sponsorizim në shumën prej 150.000 lekësh nga z. Xh. H.

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar sponsorizim për botim libri nga z. Xh. H. në vlerën prej 150.000 lekësh, provuar me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2016.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar sponsorizim për botim libri, shumën prej 150.000 lekësh, por nuk ka deklaruar individin sponsorizues.

Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se sponsorizimi në shumën prej 150.000 lekësh nga shtetasi Xh. H. ka shërbyer për botimin e librit “Fjalori i termave të së drejtës italisht-shqip-italisht”, provuar me deklaratën noteriale të sipërcituar në këtë paragraf dhe,

⁴² Kontratë dhurimi (shkresë e thjeshtë me një paragraf) datë 15.01.2008.

⁴³ Deklaratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2016.

⁴⁴ Deklaratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.01.2017.

⁴⁵ Deklaratë e thjeshtë, datë 30.04.2014, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

sa i përket burimit të krijimit të kësaj shume, deklaroi se z. Xh. H. ka qenë biznesmen në Gjirokastrë.

Referuar deklaratës noteriale të datës 24.10.2016 (të sipërcituar) rezulton se shtetasi Xh. H. ka deklaruar se në vitin 2004 i ka dhënë në formën e sponsorizimit shtetasit D. A., shumë prej 150.000 lekësh, për botimin e librit “Fjalor italisht-shqip-italisht”. Referuar tekstit të kësaj deklarate noteriale rezulton se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit, pasi, sipas sqarimeve të deklaratës noteriale, konstatohet se sponsorizimi në shumë prej 150.000 lekësh është kryer në favor të z. D. A., dhe se kjo shumë është sponsorizuar në vitin 2004 dhe jo në vitin 2005, kur është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit.

21.7 Sa më sipër, në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi se shtetasit M. Ç., E. Z., V. Dh., A. M. dhe Xh. H. bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave, që kanë shërbyer për krijimin e shumave të pretenduara si të dhëna hua, dhuruara apo të dhëna në formë shpërblimesh, ndihmë financiare apo sponsorizim në favor të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur. Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion ligjor për personat e tjerë të lidhur, për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojnë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumave të pretenduara si të dhëna hua, dhuruara apo të dhëna në formë shpërblimesh e sponsorizimesh.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor provues për të ardhurat e personave të tjerë të lidhur evidentuar si më sipër dhe nuk ka paraqitur as prapësime mbi rezultatet e hetimit në Komision. Duke qenë se subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor se personat e tjerë të lidhur kishin mundësi me burime financiare të ligjshme për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit shumat e mësipërme, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ashtu si edhe Komisioni, vlerësoi se vlerat monetare të deklaruara si dhurime, hua, shpërblime, sponsorizime apo ndihma financiare të mos reflektohen si të ardhura në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, duke mos i konsideruar ato si burim për krijimin e pasurive apo mbulimin e shpenzimeve në vitet përkatëse.

22. Lidhur me konkluzionet e Komisionit, në paragrafët e vendimit nr. 61.2 (të ardhurat nga shitja e librave), nr. 62.1 (llogaria bankare dyemërore), nr. 63.11 (automjet në përdorim) dhe nr. 64.3 (apartament në {***}), subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur shkaqe ankimore, për rrjedhojë ato mbeten në fuqi, sipas vendimit të Komisionit.
23. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ken Dhima gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 428, datë 29.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 428, datë 29.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ken Dhima.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.01.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi